



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 177

Tiranë – E mërkurë, 14 tetor 2015

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 30.9.2015	Për miratimin e planit të masave kundër informalitetit në fushën e transportit rrugor..... 12041
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 7.10.2015	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog (AMQHD)..... 12043
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 7.10.2015	Për miratimin e rregullores së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë..... 12045
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 819, datë 7.10.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitin 2015, miratuar për Gjykatën Kushtetuese..... 12059
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015	Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni..... 12060
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 7.10.2015	Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale..... 12069
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 7.10.2015	Për krijimin, administrimin dhe përdorimin e Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara..... 12081
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 825, datë 7.10.2015	Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për dhënien e lejes për hapjen, mbylljen dhe funksionimin e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj..... 12084
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 7.10.2015	Për përcaktimin e procedurave, kritereve dhe afateve për ndjekjen e programeve të formimit e të kualifikimit profesional për individët që ushtrojnë profesionin e punonjësit social për një periudhë të caktuar kohe, por nuk kanë formimin dhe kualifikimin profesional minimal për punonjës social..... 12087

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 7.10.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara” .....	12089
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 828, datë 7.10.2015	Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.....	12089
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 830, datë 7.10.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar”.....	12090
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 831, datë 7.10.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 82, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës “Don Gjon Buzuku”, Korçë”.....	12091
Udhëzim i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 8, datë 15.9.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 3.6.2010 “Kuari rregullativ në qiellin e vetëm evropian”, në udhëzimin nr. 6, datë 3.6.2010 “Mbi dispozitat e shërbimit të navigimit ajror në qiellin e vetëm evropian”, në udhëzimin nr. 7, datë 3.6.2010 “Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda qiellit të vetëm evropian” dhe në udhëzimin nr. 8, datë 3.6.2010 “Për ndërveprimin në rrjetin evropian të menaxhimit të trafikut ajror”, me qëllim përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmërisë së sistemit të aviacionit civil.....	12093
Urdhër i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 124, datë 28.9.2015	Për miratimin e rregullores për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore.....	12104



**VENDIM**  
**Nr. 806, datë 30.9.2015**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE  
KUNDËR INFORMALITETIT NË  
FUSHËN E TRANSPORTIT RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e planit të masave kundër informalitetit në fushën e transportit rrugor, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**PLANI I MASAVE KUNDËR INFORMALITETIT  
NË FUSHËN E TRANSPORTIT RRUGOR**

Nr	EMËRTIMI	MASAT			
		Ndryshime të akteve ligjore të nevojshme	Veprime operative	Institucionet përgjegjëse për zgjidhjen e problemit	Koha e fillimit
1	<b>Mjete transporti udhëtarësh të palicencuar.</b>  Qëndrimi i autovecurave të palicencuara në shërbimin taksi dhe i autobusëve në vende të ndryshme brenda territorit të bashkisë, si dhe operimi në rrugë i këtyre mjeteve kur kryejnë aktivitet ekonomik të pajegjistruar	Nuk ka nevojë (Neni 85/2 i Kodit Rrugor dhe neni 41 i ligjit të procedurave tatimore, neni 180, Kodi Penal)	Grupe Task - Force të përbëra nga efektivë të Policisë Rrugore dhe inspektorët e kontrollit në rrugë të DPSHTRR  Në rast evidentimi shkeljeje masa administrative dhe masë plotësuese tërheqje leje qarkullimi dhe konfiskim mjete; Në rast përsëritje procedim penal për fshehje të ardhurash;	Policia Rrugore, Inspektorët e kontrollit të DPSHTRR-së Policia e Shtetit, strukturat për krimin ekonomik dhe financiar Përgjegjësit e Task – Forcës, Drejtori i Policisë Rrugore dhe Drejtori i Kontrollit Rrugor në DPSHTRR. Bashkëndimi do të jetë mbi bazë qarqesh. Organet e mësipërme përgatitën plane operacionale masash dhe bashkëveprojnë në zbatimin e tyre	Tetor 2015 Raportim çdo 10 ditë në MTI dhe MPB
2	<b>Taksimetri dhe komoditeti</b>  Autovetura taksi të papajisjura me taksimetër ose me taksimetër jofunksional. Autovetura taksi dhe autobusë pa aktin e komoditetit.	Nuk ka nevojë (Neni 85/3 i Kodit Rrugor dhe neni 122 i ligjit të procedurave tatimore)	Grupe Task - Force të përbëra nga efektivë të Policisë Rrugore, inspektorët e kontrollit në rrugë të DPSHTRR-së dhe inspektorët e tatim - taksave. Në rast evidentimi shkeljeje masa administrative dhe masë plotësuese tërheqje licence.	Përgjegjësit e Task - Forcës Drejtori i Policisë Rrugore dhe Drejtori i Kontrollit Rrugor në DPSHTRR.	Tetor 2015
3	<b>Monitorimi i subjekteve që operojnë në shërbimin taksi</b> Mungesa e regjistrimit elektronik kombëtar për të gjithë subjektet e licencuara në shërbimin taksi”	Krijimi i regjistrimit elektronik për subjektet e licencuara në shërbimin taksi  Përmirësimi i legjislacionit mbi shërbimin taksi (licenca sipas	DPSHTRR-ja krijon regjistrin elektronik për subjektet e licencuara në shërbimin taksi, në bashkëpunim me pushtetin vendor	DPSHTRR-ja dhe bashkitë  MTI/MPB MPB/MTI/Bashkitë	Janar 2016



		numrit të banorëve dhe/ose numrit të mjeteve, kushte komoditeti shtesë)			
4	<b>Biletimi i udhëtarëve</b> Transportuesi nuk pajis me bileta udhëtarët në transportin me autobus. Aktualisht, transportuesi i tërheq biletat sipas legjislacionit në fuqi në zyrën e tatim-taksave ku është i regjistruar.	Nuk ka nevojë (Neni 10, neni 68 i ligjit nr.8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", neni 122 i ligjit t137 procedurave tatimore)	Forcimi i kontrollit në rrugë i Drejtorisë së Kontrollit në DPSHTRR (të krijohet njësi inteligjente për kontroll) me inspektorët e tatimeve. Të ekzaminohen faturat e blerjes së biletave me shumat totale të biletave të shitura. Njoftim publik për detyrimin e pajisjes me bileta të udhëtarëve brenda 1 jave.  Në çdo rast evidentimi shkeljeje gjohë dhe pezullim licence ose certifikatë deri në 6 muaj.	Inspektorët e kontrollit të DPSHTRR-së, Inspektorët e tatim- taksave	1 javë pas njoftimit publik
5	<b>Regjistrimi i mjeteve.</b> Regjistrimi i mjeteve të përdorura për herë të parë, të cilat zënë rreth 90% të tregut të mjeteve të importuara dhe që shumica tregtohen në mënyrë informale.  Individë të palicencuar që tregtojnë me dhjetra mjete të importuara në vit	Akt ligjor për rregullimin dhe përcaktimin e veprimeve të shitblerjes së mjeteve të përdorura.  Ndryshime në ligjin për QKR-në dhe ndryshime në VKM nr.1058, datë 21.10.2009, "Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit të TVSH-së"	Tregtari i cili evidentohet që në doganë si importues i mjetit, përpara se të shesë mjetin, të detyrohet ose ta regjistrojë në emër të tij ose ta shesë me faturë tatimore. Noterët të mos kryejnë asnjë veprim shitblerjeje, pa qenë mjeti i regjistruar në DPSHTRR  Të kufizohet numri i mjeteve që mund të importojë një individ (jo më shumë se 2 në vit)  Në rast evidentimi shkeljesh për aktivitet pa licencë procedim penal sipas nenit 180 të Kodit Penal për fshehje të ardhurash	Ministria e Drejtësisë MTI Ministria e Financave Dhoma Kombëtare Notereve Ministria e Ekonomisë Policia e Shtetit, strukturat për Krimin Ekonomik dhe Financiar	Nëntor 2015  Menjëherë pas miratimit të ndryshimit të akteve ligjore
6	<b>Ndërimi i pronësisë së mjeteve</b>	Akt ligjor që synon të rregullojë procedurat e shitblerjes me	Kontrata notoriale vetëm me leje qarkullimi dhe certifikatë	KM Ministria e Drejtësisë	Nëntor 2015
	Ndërimi i pronësisë së mjeteve rrugore të regjistruara të pajisura me targa dhe leje qarkullimi.  Aktualisht kryhen transaksione shitjeje mjetesh dhe pronarët e rinj nuk regjistrohen në DPSHTRR. Mjetet e shitura janë debitorë në taksa	kontrata notoriale për mjetet.	pronësi të lëshuar nga DPSHTRR-ja. Verifikimi <i>on-line</i> nga noterët në sistemin e DPSHTRR-së për statusin e mjetit përpara hartimit të kontratës (pasi ka mjete të bllokua nga tatimet, zyrat përbarimore etj). Deklarimi në formë elektronike nga noterët i kontratës së shitblerjes në DPSHTRR. DPSHTRR njofton DPPSH për transaksionin	MTI Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Financave Dhoma Kombëtare Notere	
7	<b>Çregjistrim i mjeteve</b> Çregjistrim i përhershëm i mjeteve të regjistruara, që nuk kanë kryer asnjë veprim për një periudhë prej më shumë se 10 vjet (rreth 90 000 mjete)	Ligj për pastrimin e detyrimeve debitorë. Personat e interesuar të kenë të drejtën deri në 3 muaj, në të kundërt veprimin e çregjistrimit e kryen DPSHTRR	Përgatitja e draftit ligjor përkatës	Ministria e Financave MTI	Dhjetor 2015
8	<b>Mjetet në fund të jetës.</b> Subjekte të palicencuara që grumbullojnë dhe trajtojnë mjete të dala jashtë qarkullimit dhe kanë aktivitet ekonomik të parregulluar	Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara si, VKM nr.705, datë 10.10.2012, "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës" dhe akti normativ nr.3, datë 7.9.2011, "Për heqjen e mjeteve motorike, rimorkiove dhe pjesëve të këmbimit që ndodhen pranë rrugëve kombëtare".	Task - forca për kontrollin e varrezave të makinave. Respektimi i distancave nga brezi i rezervuar i rrugëve kombëtare (në përputhje me VKM nr.153) Në rast evidentimi shkeljeje, gjohë + detyrimin për ta risjellë në gjendjen fillestare) Identifikimi i mjeteve që janë gjendje në varreza.  Në rast evidentimi shkeljesh për aktivitet pa licencë procedim penal sipas nenit 180 të Kodit Penal për fshehje të ardhurash	MTI; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Ministria e Mjedisit Policia e Shtetit, strukturat për krimin ekonomik dhe financiar.	Tetor 2015
9	<b>Debitorë me taksën e mjeteve</b> Persona ose subjekte debitorë për taksën vjetore të mjeteve të	Udhëzim në zbatim të ligjit për taksat.	Kufizimi i shërbimeve për subjekte tatimore në DRT, pa marrë vërtetim nga DPSHTRR-	Ministria e Financave MTI	Nëntor 2015



	përdorura (TVMP).		ja mbi gjendjen fiskale të mjeteve në zotërim.		
10	<b>Mbingarkesa e mjeteve rrugore</b> Mjetet e rënda të përfshira në transportin e karburantit, mineraleve, inerteve etj.	Nuk ka nevojë	Grupe Task Force të përbërë nga inspektorët e kontrollit në rrugë të DPSHTRR-së dhe efektivë të Policisë Rrugore	Inspektorët e kontrollit të DPSHTRR-së; Policia Rrugore; Plan operacional për kontrollin e mjeteve të rënda nga DPSHTRR-ja;	Në vazhdim
11	<b>Serviset e automjeteve.</b> Mungon legjislacioni rregullator i MZHETTS për certifikimin e tyre.	Përgatitja e VKM-ve dhe udhëzimeve përkatëse për zbatimin e ligjit nr.9573, datë 3.7.2006.  Respektimi i akteve ligjore për aktivitetin dhe largësinë e detyruar nga akset kombëtare e lokale. Kodi Rrugor (nenet 16 - 19)	Në rast evidentimi shkelje, gjobë + detyrimin për ta risjellë në gjendjen fillestare)	MZHETTS/MTI,  MTI/MPB	Janar 2016  Pas miratimit të legjislacionit
12	<b>Mungesë e tarifës së reklamave që vendosen në rrugët kombëtare dhe dëmtime të tjera në rrugë (si vizatimet, shkarravitjet dhe prishje të sinjalitikut rrugore).</b>  Vendosen reklama në rrugë dhe nuk tarifohen.  Dëmtimet e infrastrukturës nuk penalizohen.	Urdher i përbashket i MF dhe MTI për caktimin e tarifës së reklamave që vendosen në anë të rrugëve	Kontrolle të ARSH-së për reklamat dhe dëmtimet e tjera të infrastrukturës rrugore.  Vendosje masash administrative për subjektet që shkarravisin dhe dëmtojnë infrastrukturën dhe sinjalitikut rrugore (nenet 15 dhe 23 të Kodit Rrugor, shtojca bashkëlidhur)	MTI, ARSH, Min. Punëve të Brendshme	Tetor 2015

**VENDIM**

Nr. 814, datë 7.10.2015

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË  
MENAXHIMIT TË QENDRAVE PËR  
HAPJE DHE DIALOG (AMQHD)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Agjencisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog (në vijim AMQHD), si një institucion juridik publik, në varësi të Kryeministrit. AMQHD-ja ka selinë në Tiranë dhe ka vulën e stemën e saj.

2. AMQHD-ja ka mision mbështetjen e projekteve e të programeve për një shoqëri të hapur dhe institucione më pranë qytetarëve, shoqërisë civile dhe aktorëve të ndryshëm të fushës së shkencës e të artit.

3. AMQHD-ja, për të realizuar misionin, përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, kryen detyrat e mëposhtme:

a) Bashkëpunon me ministrinë, institucionet e tjera, shoqërinë civile, institucione ndërkombëtare të shkencës e të artit në mbështetje dhe promovim të projekteve, aktiviteteve, nismave, bashkëpunimeve për një shoqëri të institucioneve të hapura dhe dialogut të gjerë.

b) Bashkëpunon me ministrinë, institucionet e tjera, shoqërinë civile, institucione ndërkombëtare të shkencës dhe artit në mbështetje dhe për promovimin e një imazhi të ri për vendin tonë e rajonin, si simbole të bashkëjetesës paqësore dhe udhërrëfyes në ndërtimin e saj.

c) Bashkëpunon me ministrinë, institucionet e tjera, shoqërinë civile, institucione e përfaqësi të huaja, institucione ndërkombëtare të shkencës e të artit për krijimin, mbështetjen dhe promovimin e nismave e të praktikave kundër ekstremizmit të dhunshëm.

ç) Realizon dhe financon projekte inovative të studentëve, studiuesve, artistëve, kuratorëve, gazetarëve e aktivistëve të shoqërisë civile, për sigurimin e mjeteve e të mundësive për ndikimin e politikave publike dhe krijimin e një dialogu të gjerë që siguron institucione të hapura, transparente e më pranë qytetarëve.

d) Zbaton dhe kontribuon në strategjitë dhe politikat e qeverisë në mbështetje të studiuesve,



artistëve, qendrave të ekselencës, qendrave të hulumtimit dhe komunikimit.

dh) Zbaton strategjitë qeveritare dhe strategjitë e politikës së jashtme shqiptare dhe kontribuon për mbështetjen e dialogut mes grupeve sociale, kulturore, etnike, fetare e politike duke e kthyer atë në pjesë natyrale të kulturës demokratike në të gjithë rajonin tonë.

e) Zbaton strategjitë qeveritare për krijimin e mjeteve dhe kontribuon për mbështetjen e nismave inovative të dialogut, bashkëpunimit e të bashkëjetesës në rajonin tonë.

ë) Vlerëson dhe ofron mbështetje teknike për hartimin dhe përputhshmërinë e strategjive qeveritare me misionin e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 3, të këtij vendimi.

f) Promovon bashkëpunim me sektorin privat në mbështetje të misionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, dhe të iniciativave inovative për hapje e dialog në fushën e artit, shkencës dhe kërkimit.

g) Zhvillon bashkëpunime dypalëshe dhe shumëpalëshe me sektorin publik e privat, vendas dhe të huaj, në shërbim të misionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi.

gj) Kontribuon në krijimin e kushteve për bashkëpunim dhe intensifikimin e bashkëpunimit mes politikëbërësve dhe akademikëve, ekspertëve të shquar ndërkombëtarë, personaliteteve në fushën e artit e të kulturës.

h) Kontribuon në zhvillimin e politikave, legjislacionit, strategjive për inovacionin, transparencën, artin, arsimin, rininë, grupet vulnerabel.

i) Propozon e inicion nisma dhe menaxhon qendra në përmbushje të misionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, brenda dhe jashtë vendit, mbështetur në legjislacionin shqiptar ose në bazë të marrëveshjeve dy-ose shumëpalëshe.

4. AMQHD-ja është institucion buxhetor dhe financohet nga:

a) buxheti i shtetit;

b) burime të tjera të ligjshme.

5. AMQHD-ja përdor buxhetin për fondin e pagave të punonjësve dhe për shpenzime të tjera në funksion të përmbushjes së funksionimit e të realizimit të detyrave të Agjencisë.

6. Organet e AMQHD-së janë:

a) Drejtori i Përgjithshëm (organ drejtues);

b) Bordi Këshillimor.

7. Drejtori i Përgjithshëm i AMQHD-së është titullar i institucionit, i cili emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri dhe e përfaqëson agjencinë në marrëdhënie me të tretë.

8. Bordi Këshillimor është organ kolegjal këshillimor që drejtohet me rotacion 6-mujor nga anëtarët e tij.

8.1 Bordi Këshillimor miratohet me urdhër të Kryeministrit dhe përbëhet nga 15 anëtarë, shqiptarë dhe të huaj, të njohur për veprimtari në lidhje me misionin dhe fushat e veprimit të AMQHD-së.

8.2 Në përbërje të Bordit Këshillimor janë:

- anëtarë/drejtes të organizatave shqiptare të shoqërisë civile;

- pjesëtarë të trupit diplomatik të akredituar në Shqipëri;

- anëtarë/drejtes të dhomave/unioneve të tregtisë shqiptare dhe të huaja;

- ekspertë, akademikë, profesorë të universiteteve prestigjioze, shqiptare dhe të huaja;

- përfaqësues të institucioneve të ngjashme, publike ose private, të vendeve të tjera;

- ekspertë të njohur, të huaj dhe vendas, me kontribut ose potencial për kontribut në misionin e AMQHD-së.

9. Funksionet kryesore të Bordit Këshillimor janë:

a) Propozon ndryshime në kalendarin e aktiviteteve të AMQHD-së dhe miraton raportin e veprimtarisë së kësaj agjencie, që i dërgohet Kryeministrit dhe bëhet publik.

b) Propozon aktivitete, programe, projekte për AMQHD-në.

c) Ka të drejtë të sugjerojë ndryshime në programet, financimet dhe projektet në të cilat përfshihet AMQHD-ja.

ç) Ka të drejtë të japë vlerësime për stafin e AMQHD-së dhe për të gjitha llojet e kontratave në të cilat përfshihet kjo agjenci.

d) Ka të drejtë të japë sugjerime për përfaqësimin e AMQHD-së pranë palëve të treta.

dh) I sugjeron AMQHD-së angazhime në marrëdhënie dypalëshe dhe shumëpalëshe me palë të treta, brenda dhe jashtë vendit.

10. AMQHD-ja, për çështjet e përmbajtjes dhe vlerësimit të programeve e të projekteve





mbështetet në ekspertizën e anëtarëve të Bordit Këshillimor ose në ekspertizën e komisioneve të programeve e të projekteve që propozohen nga drejtori i Përgjithshëm në konsulencë me bordin dhe në përputhje me rregulloren e funksionimit të kësaj agjencie.

11. Struktura e kësaj agjencie miratohet, me urdhër të Kryeministrit, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

12. Funksionimi i AMQHD-së rregullohet në përputhje me rregulloren e funksionimit të kësaj agjencie e cila përgatitet nga drejtori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me Bordin dhe miratohet me urdhër të Kryeministrit.

13. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve /punonjësve të AMQHD-së rregullohen me Kodin e Punës.

14. Drejtori i Përgjithshëm dhe anëtarët e bordit emërohen/caktohen brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

15. Për vitin 2015, AMQHD-ja financohet nga buxheti i miratuar për Kryeministrinë.

16. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, zëri “Investime,” t’i shtohen fondet për financimin e AMQHD-së, si më poshtë vijon:

a) 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për rikonstruksionin dhe pajisjen e mjediseve të punës të kësaj agjencie;

b) 3 000 000 (tre milionë) lekë për paga e shpenzime të tjera të nevojshme për veprimtarinë e AMQHD-së;

c) 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për investime.

17. Fondet e përmendura në pikën 16, të këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

18. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

## VENDIM

Nr. 816, datë 7.10.2015

### PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË SHËRBIMIT TË JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 58, të ligjit nr. 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i kësaj rregulloreje, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

3. Vendimi nr. 839, datë 17.12.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit “Rregullorja e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet ministri i Punëve të Jashtme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

## RREGULLORE

### PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### KREU I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo rregullore ka për objekt rregullimin e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe legjisllacionin për nëpunësin civil.

2. Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga strukturat e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), si dhe misionet diplomatike e postet konsullare jashtë vendit.

3. Diplomatët e karrierës kryejnë veprimtari diplomatike dhe konsullare në strukturat e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe në misionet diplomatike e postet konsullare. Këtu nuk përfshihen strukturat e Ministrisë, veprimtaria e të cilave përcaktohet në nenin 56, të ligjit nr. 23/2015.



4. Diplomatët e karrierës rekrutohen në Shërbimin e Jashtëm në përputhje me legjislacionin për nëpunësin civil dhe ligjin nr. 23/2015.

## KREU II PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

1. Sekretari i Përgjithshëm përzgjidhet në këtë detyrë nga ministri i Punëve të Jashtme, pas konkurrimit të hapur në radhët e diplomatëve me gradën diplomatike personale “Ministër Këshilltar”, “Ministër Fuqiplotë” ose “Ambasador”.

2. Çdo diplomat i interesuar, brenda 15 ditëve pas shpalljes së konkursit, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, të shoqëruar me një platformë të detajuar për vizionin e tij për zhvillimin e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm dhe për rolin e funksionit që ai do të luajë si sekretar i Përgjithshëm në këtë shërbim.

3. Kandidaturat për postin e sekretarit të Përgjithshëm shqyrtohen nga një komision i posaçëm, i cili ngrihet me urdhër të ministrit të Punëve të Jashtme dhe përbëhet nga pesë anëtarë, nga radhët e diplomatëve me gradën personale “Ministër Këshilltar”, “Ministër Fuqiplotë” ose “Ambasador”.

4. Konstituimi, mbledhja dhe detyrat e komisionit përcaktohen në urdhrin e ministrit për ngritjen e tij.

## KREU III KOMISIONI I KARRIERËS DIPLOMATIKE

1. Komisioni i Karrierës Diplomatike ngrihet me urdhër të ministrit të Punëve të Jashtme dhe përbëhet nga 5 anëtarë. Komisioni drejtohet nga sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së dhe në përbërje të tij janë drejtori i Burimeve Njerëzore dhe tre diplomatë karriere, me gradën diplomatike personale “Ministër Këshilltar”, “Ministër Fuqiplotë” ose “Ambasador”, të cilët përzgjidhen vetëm për një sesion pune të Komisionit.

2. Komisioni i Karrierës Diplomatike kryen funksionet, si më poshtë vijon:

a) shqyrton kërkesat e diplomatëve për marrjen e gradave diplomatike dhe merr vendim për pranimin ose refuzimin e tyre;

b) shqyrton dhe zgjidh ankesat për shkelje të klasifikuara të rënda dhe shumë të rënda, të kryera nga diplomatët;

c) kryen testimin për nëpunësit gjatë periudhës së provës, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr. 23/2015, dhe parashikimet e kësaj rregulloreje;

ç) kryen testimin për diplomatët, të cilët paraqesin kërkesën për marrjen e gradës diplomatike personale “Këshilltar”;

d) organizon ceremoninë e betimit, sipas pikës 2, të nenit 39, të ligjit nr. 23/2015.

3. Konstituimi, mbledhja dhe detyrat e Komisionit të Karrierës Diplomatike përcaktohen në urdhrin e ministrit për ngritjen e Komisionit. Mbledhja e Komisionit zhvillohet me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtën e një vote. Procesi i votimit është i hapur dhe nuk lejohet vota abstenuese.

4. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni ndihmohet nga një sekretar teknik, e cila, me aktin e ministrit për krijimit të Komisionit, caktohet dhe operon pranë tij. Sekretaria teknike ka për detyrë të kujdeset për shkëmbimin e informacionit, dërgimin e njoftimeve, përgatitjen e materialeve që shqyrtohen në mbledhjen e Komisionit të Karrierës Diplomatike, si dhe të mbajtjes dhe administrimit të procesverbaleve të mbledhjes.

## KREU IV REKRUTIMI NË SHËRBIMIN E JASHTËM

### SEKSIONI 1 PROCEDURA E REKRUTIMIT

1. MPJ-ja i paraqet DAP-it pozicionet e lira të institucionit, sipas afateve kohore të përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil. Njoftimi për shpalljen e vendeve të lira shoqërohet nga kriteret e veçanta për pozicionet përkatëse.

2. Kriteret e veçanta për vendin e lirë hartohen nga drejtori i drejtorisë ku është hapur vendi vakant dhe i paraqiten Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

3. Kandidati për t'u rekrutuar në sistemin e karrierës diplomatike duhet të paraqesë, krahas dokumentacionit për pranim në Shërbimin e Jashtëm, një deklaratë personale me anën e së cilës të deklarojë se nuk bën pjesë në asnjë parti apo shoqatë politike si dhe faktin që nuk ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit.





## SEKSIONI 2 PROCEDURA E TESTIMIT GJATË PERIUDHËS SË PROVËS

1. Nëpunësi i përzgjedhur nga DAP-i, që emërohet për herë të parë në Shërbimin e Jashtëm, përveç detyrimeve të parashikuara për ndjekjen e ciklit të detyrueshëm pranë ASPA-s, i nënshtrohet, gjatë periudhës së provës, edhe një procedure trajnimi dhe testimi pranë MPJ-së, e cila përbëhet nga dy faza:

a) Faza e parë përfshin:

i) Trajnimin e detyrueshëm pranë strukturave të MPJ-së për një periudhë tremujore.

ii) Vlerësimin e njohurive të përfituara gjatë trajnimit për çdo sesion trajnimi. Vlerësimi kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në programin trajnues nga struktura përkatëse në MPJ.

b) Faza e dytë përfshin:

i) Vlerësimin e rezultateve individuale në punë, i cili bëhet nga eprori direkt, në përputhje me parashikimet e ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore të dala në varësi të tij.

ii) Vlerësimin etiko-profesional, i cili kryhet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike.

2. Vlerësimi etiko-profesional kryhet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike, sipas kësaj procedure:

a) Në përfundim të tremujorit të tretë të periudhës së provës nëpunësi i nënshtrohet testimit me shkrim, i cili zhvillohet nën mbikëqyrjen e Komisionit të Karrierës Diplomatike. Pyetjet e testimit hartohen nga struktura trajnuese në MPJ, në përputhje me njohuritë dhe aftësitë e posaçme që duhet të zotërojë nëpunësi, të cilat janë të lidhura me pozicionin e punës në të cilin është emëruar. Struktura trajnuese në MPJ përgatit një paketë me, të paktën, 100 pyetje. Një orë përpara testimit, Komisioni i Karrierës Diplomatike përzgjedh 10 pyetje nga kjo paketë. Secila nga pyetjet vlerësohet me 10 pikë. Nëpunësi duhet të grumbullojë, të paktën, 50 pikë për t'u klasifikuar se e ka kaluar testimin me shkrim. Kohëzgjatja e testimit është tre orë.

b) Pas përfundimit të testimit me shkrim, nëpunësi i nënshtrohet testimit me gojë. Testimi me gojë kryhet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë t'i drejtojë dy pyetje nëpunësit që testohet dhe, për çdo pyetje, ka në dispozicion 10 pikë. Në fund të

testimit nëpunësi duhet të grumbullojë, të paktën 50 pikë, për t'u klasifikuar se ka kaluar testimin me gojë.

c) Në përfundim të dy testeve Komisioni i Karrierës Diplomatike bën vlerësimin e nëpunësit dhe shprehet me vendim për rezultatin e testimit. Në rast se nëpunësi, në përfundim të dy testeve, pavarësisht se mund të mos ketë grumbulluar pikët minimale në njërin testim, grumbullon, në total, të paktën, 100 pikë, kualifikimi i tij vendoset me votim nga Komisioni, ku vota e kryetarit është vendimtare. Komisioni i Karrierës Diplomatike, në këtë rast, nëse e kualifikon nëpunësin, urdhëron që nëpunësi t'i nënshtrohet një trajnimi të thelluar pranë strukturës trajnuese në MPJ, në fushën ku janë vërejtur mangësitë.

ç) Në përfundim të testimit Komisioni i Karrierës Diplomatike shprehet me vendim për kualifikimin ose jo të nëpunësit.

d) Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike i përcillet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e cila e administron këtë vendim së bashku me vlerësimet e tjera. Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike, vlerësimi i eprorit direkt dhe vlerësimi i strukturës trajnuese në MPJ i përcillen, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ministrit, jo me vonë se një muaj përpara përfundimit të periudhës së provës. Ministri shprehet me vendim për pranimin ose mospranimin e nëpunësit në sistemin e karrierës. Vendimi i ministrit u njoftohet, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nëpunësit dhe strukturave përkatëse në MPJ dhe DAP, brenda afateve të parashikuara në ligj.

## KREU V GRADAT DIPLOMATIKE

### SEKSIONI 1 SISTEMI I GRADAVE DIPLOMATIKE

1. Sistemi i gradave diplomatike mbështetet në kriteret e përcaktuara në nenet 46, 47 e 48, të ligjit nr. 23/2015.

2. Diplomati e fiton gradën diplomatike personale me firmosjen e urdhrit nga ministri, ndërsa efektet financiare nisin nga data 1 e muajit pasardhës.

3. Grada diplomatike nga "Atashe" në "Këshilltar" përfitohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 23/2015.



4. Grada diplomatike personale “Këshilltar” përfitohet pas kalimit me sukses të testimit, i cili zhvillohet nga Komisioni i Karrierës Diplomatiqe.

5. Grada diplomatike personale “Ministër Këshilltar” dhe “Ministër Fuqplotë”, përveç kushteve të pikës 1, të nenit 47, përfitohet nga diplomati, i cili ka pasur, të paktën, dy vjet eksperiencë në poste drejtuese, për secilën gradë, si dhe ka shërbyer në misionet diplomatike apo postet konsullore.

6. Për qëllimet e interpretimit të pikës 5, të nenit 47, “post drejtues” nënkupton:

a) drejtor i Drejtorisë, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme, sekretar i Përgjithshëm;

b) Kre i misionit diplomatik ose postit konsullor, i ngarkuar me punë.

7. Përvoja në poste drejtuese nënkupton, për gradën “Ministër Këshilltar”, një periudhë minimale dyvjeçare akumulimi përvoja, dhe katërvjeçare akumulimi për gradën “Ministër Fuqplotë”.

8. Grada diplomatike personale “Ambasador” përfitohet nga diplomati, i cili ka fituar njëra pas tjetrës të gjitha gradat diplomatike, sipas ligjit nr. 23/2015, dhe ka qenë në detyrën e kreut të misionit diplomatik, të paktën, dy funksione, por jo më pak se gjashtë vjet gjithsej.

9. Numri i diplomatëve të karrierës që përfitojnë gradat diplomatike “Ministër Këshilltar”, “Ministër Fuqplotë” ose “Ambasador” është jo më i lartë se 80, të ndarë, sipas gradave diplomatike, si më poshtë vijon:

i) Ambasadorë – 5

ii) Ministra Fuqplotë – 35

iii) Ministra Këshilltarë – 40

## SEKSIONI 2

### PROCEDURA E DHËNIES SË GRADAVE DIPLOMATIKE

1. Komisioni i Karrierës Diplomatiqe mblidhet për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e gradave diplomatike, si rregull, dy herë në vit, në varësi të paraqitjes së kërkesave të diplomatëve të karrierës.

2. Komisioni i Karrierës Diplomatiqe merr në shqyrtim të gjitha kërkesat për përfitimin e gradave diplomatike personale, që plotësojnë kriteret, në përputhje me përcaktimet e nenit 47, të ligjit nr. 23/2015, dhe të kësaj rregulloreje, për gradat diplomatike personale “Atashe” deri në “Ministër Fuqplotë”.

3. Diplomati i karrierës, për marrjen e gradës diplomatike personale, i drejtohet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ditën që i lind e drejta për të përfituar ngritjen në gradë.

4. Drejtorja e Burimeve Njerëzore, pas marrjes së kërkesës së diplomatit për ngritjen në gradë, përgatit dosjen personale të tij. Dosja personale përgatitet mbi bazën e të dhënave personale, që ndodhen të administruara në kartotekën e institucionit. Përmbajtja e dosjes i bëhet me dije diplomatit, i cili, në rast se ka të dhëna shtesë, të cilat nuk gjenden të administruara në dosje, i përcjell ato, brenda afateve të cilat përcaktohen nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore. Dosja e diplomatit, i cili kërkon shqyrtimin e kërkesës për marrjen e gradës diplomatike, duhet të përmbajë:

a) formularin e kërkesës, të nënshkruar nga diplomati;

b) të dhënat mbi kualifikimet profesionale;

c) formularin e vlerësimeve vjetore të dy viteve të fundit;

ç) formularin e vlerësimeve periodike të vitit kur paraqitet kërkesa;

d) vendimin e Komisionit të Karrierës Diplomatiqe për kalimin me sukses ose jo të testimit, për diplomatët që kërkojnë marrjen e gradës diplomatike “Këshilltar”;

dh) gradën që diplomati kërkues mban dhe datën e dhënies së saj.

5. Formulari i kërkesës hartohet nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm.

6. Kërkesa e diplomatit, së bashku me dosjen e formuar sipas parashikimeve të pikës 4, të këtij seksioni, pas dhënies së pëlqimit për përmbajtjen e saj nga diplomati, i përcillet Komisionit të Karrierës Diplomatiqe nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore, në sesionin më të afërt që vijon pas paraqitjes së kërkesës. Diplomati njoftohet nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore për përgatitjen e dosjes personale dhe përcjelljen e saj pranë Komisionit të Karrierës Diplomatiqe.

7. Sekretaria teknike e Komisionit të Karrierës Diplomatiqe administron materialet e përcjella nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe përgatit një relacion përmbledhës për Komisionin e Karrierës Diplomatiqe, në të cilin përshkruhen emrat e diplomatëve që kanë aplikuar për secilin rang të gradave diplomatike.

8. Relacioni, së bashku me rendin e ditës,



vendin dhe orën e mbledhjes së Komisionit të Karrierës Diplomatike, i njoftohet anëtarëve nga sekretaria teknike, pasi të jetë nënshkruar nga kryetari i Komisionit.

9. Komisioni i Karrierës Diplomatike merr në shqyrtim kërkesat e diplomatëve të interesuar për marrjen e gradës diplomatike, duke shqyrtuar secilën kërkesë, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe dokumentacionin e administruar në dosje.

10. Vlerësimi i kërkesës bëhet sipas formularit të vlerësimit. Formulari i vlerësimit hartohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, miratohet nga ministri dhe i bashkëlidhet urdhrin të ministrit për ngritjen e Komisionit të Karrierës Diplomatike.

11. Formularët e vlerësimit plotësohen me shkrim dore. Pas përfundimit të vlerësimit, formularët administrohen nga sekretaria teknike, e cila mbledh vlerësimet pro dhe kundër të secilit anëtar.

12. Rezultati i vlerësimit lexohet nga kryetari i Komisionit të Karrierës Diplomatike dhe, pasi vlerësohet saktësia e tij, shpallet vendimi përfundimtar për secilin aplikues.

13. Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike merret me shumicë të thjeshtë dhe duhet të përmbajë:

- a) pjesën hyrëse;
- b) pjesën arsyetuese;
- c) vlerësimin e detajuar për çdo aplikues, vlerësimet e marra pro dhe kundër;
- ç) dispozitivin.

14. Në mbarim të seancës së punës të Komisionit, sekretaria teknike administron aktet e mbledhjes dhe harton procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, me datën e zhvillimit të seancës, përbërjen dhe drejtimin e Komisionit.

15. Kryetari i Komisionit të Karrierës Diplomatike i dorëzon ministrit, brenda ditës, dokumentacionin e plotë të seancës së Komisionit. Ministri vendos për propozimet e Komisionit të Karrierës Diplomatike brenda tre ditëve, nga marrja e tyre.

### SEKSIONI 3 PROCEDURA E DHËNIES SË GRADËS DIPLOMATIKE “KËSHILLTAR”

1. Për të përfituar gradën diplomatike “Këshilltar”, diplomati i karrierës duhet t’u

nënshtrohet procedurave të testimit, në të cilat përfshihen kriteret bazë për vlerësimin e kandidatit, që janë:

- a) vlerësimi i eprorit direkt;
- b) testimi me shkrim;
- c) testimi me gojë;
- ç) mungesa e masës disiplinore “të rëndë” në tre vitet e fundit.

2. Pyetjet e testimit me shkrim hartohen nga struktura trajnuese në MPJ, në përputhje me njohuritë dhe aftësitë e posaçme që duhet të zotërojë diplomati për të përfituar gradën diplomatike “Këshilltar”. Struktura trajnuese në MPJ përgatit një paketë me, të paktën, 100 pyetje. Një orë përpara testimit, Komisioni i Karrierës Diplomatike përzgjedh 10 pyetje nga kjo paketë. Secila nga pyetjet vlerësohet me 10 pikë. Diplomati duhet të grumbullojë, të paktën, 50 pikë për tu klasifikuar se e ka kaluar testimin me shkrim. Kohëzgjatja e testimit është tre orë.

3. Pas përfundimit të testimit me shkrim, diplomati i nënshtrohet testimit me gojë. Testimi me gojë kryhet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë t’i drejtojë dy pyetje diplomatit që testohet dhe, për çdo pyetje, ka në dispozicion 10 pikë. Në fund të testimit diplomatit duhet të grumbullojë, të paktën, 50 pikë për t’u klasifikuar se e ka kaluar testimin me gojë.

4. Në përfundim të dy testeve, Komisioni i Karrierës Diplomatike bën vlerësimin e diplomatit dhe shprehet me vendim për rezultatin e testimit. Në rast se diplomati, në përfundim të dy testeve, pavarësisht se mund të mos ketë grumbulluar pikët minimale në njërin testim, grumbullon, në total, të paktën, 100 pikë, kualifikimi i tij vendoset me votim nga Komisioni, ku vota e kryetarit është vendimtare. Komisioni i Karrierës Diplomatike, në këtë rast, nëse e kualifikon diplomatit, urdhëron që diplomati t’i nënshtrohet një trajnimit të thelluar, pranë strukturës trajnuese në MPJ, në fushën ku janë vërejtur mangësitë.

5. Në përfundim të testimit, Komisioni i Karrierës Diplomatike shprehet me vendim për kalimin me sukses ose jo të testimit nga diplomati që kërkon marrjen e gradës diplomatike “Këshilltar”.

6. Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike i përcillet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e cila administron këtë vendim.



7. Për rastet e pamundësisë së pjesëmarrjes fizike, të diplomatit që aplikon për gradën personale “Këshilltar”, për shkak të emërimit të tij në një mision diplomatik ose post konsullor, procedura e testimit përcaktohet me një udhëzim të veçantë të ministrit të Punëve të Jashtme.

## KREU VI TRANSFERIMI, LËVIZJA PARALELE DHE NGRITJA NË DETYRË

### SEKSIONI 1 PUNËSIMI NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

1. Transferim nënkupton punësimin e përkohshëm të diplomatit të karrierës në institucionet e administratës shtetërore, në pozicione që mbulojnë marrëdhëniet me jashtë.

2. Periudha e transferimit jashtë Shërbimit të Jashtëm merret në konsideratë në përlllogaritjen e afatit kohor të nevojshëm për përfitimin vetëm të një grade diplomatike.

3. Marrëveshja, ndërmjet MPJ-së dhe institucionit tjetër, parashikon:

a) pozicionin në fushën e marrëdhënieve me jashtë, që do të ketë diplomati i karrierës në institucionin ku transferohet;

b) afatin e punësimit, sipas nevojave të të dy institucioneve;

c) të drejtat dhe detyrimet e diplomatit të karrierës;

ç) detyrimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për rikthimin e diplomatit në Shërbimin e Jashtëm.

### SEKSIONI 2 PUNËSIMI NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshja e punësimit të diplomatit të karrierës pranë organizatave ndërkombëtare, ndërmjet MPJ-së dhe këtij diplomatit, duhet të përmbajë:

a) pozicionin e punës pranë kësaj organizate, i cili nuk duhet të jetë teknik apo administrativ;

b) afatin e punësimit;

c) të drejtat dhe detyrimet e diplomatit;

ç) detyrimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për rikthimin e diplomatit në Shërbimin e Jashtëm.

2. Periudha e punësimit në organizatat ndërkombëtare merret në konsideratë në përlllogaritjen e afatit kohor të nevojshëm për

përfitimin vetëm të një grade diplomatike personale.

3. Në rastin e aplikimit për gradën “Këshilltar”, diplomati është i detyruar të kalojë me sukses testimin, sipas pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 23/2015.

## SEKSIONI 3 LËVIZJA PARALELE DHE NGRITJA NË DETYRË

1. Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë, për diplomatin e karrierës, brenda strukturave të MPJ-së, bëhet për plotësimin e vendeve të lira dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së punës. Ky proces bazohet në përzgjedhjen, sipas aplikimeve të paraqitura nga diplomatët e karrierës.

2. Procedura e lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë të diplomatit të karrierës mbështetet në:

a) aftësitë profesionale;

b) përvojën individuale të diplomatit aplikues;

c) përputhshmërinë e gradës diplomatike të kandidatit me kërkesat e vendit të lirë;

ç) nivelin e vlerësimit vjetor të punës, të paktën “mirë”, nga eprori direkt;

d) specifikën e vendit të lirë;

dh) të mos ketë masë disiplinore në fuqi, në momentin e aplikimit.

3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore shpall vendin e lirë, duke përcaktuar një afat pesëditor për paraqitjen e aplikimeve individuale të diplomatëve të karrierës.

4. Aplikimet mbledhen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, e cila studion të dhënat vetjake, që ndodhen në dosjet e diplomatëve aplikues, dhe bën përzgjedhjen e tyre, në bazë të parimeve dhe kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të këtij seksioni.

5. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, brenda tre ditëve nga marrja e aplikimeve, i paraqet eprorit direkt dhe sekretarit të Përgjithshëm listën e aplikuesve, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij seksioni, shoqëruar nga një relacion për secilën kandidaturë.

6. Sekretari i Përgjithshëm dhe eprori direkt, brenda tre ditëve kalendarike, i paraqesin ministrit listën e kandidaturave, me propozimin për kandidaturën e vlerësuar si më të përshtatshme për plotësimin e vendit të lirë.



## SEKSIONI 4

LËVIZJET PARALELE NË STRUKTURAT  
E MPJ-së PA GRADA DIPLOMATIKE DHE  
ANASJELLTAS

1. Diplomatët e karrierës mund të aplikojnë për emërim në një vend të lirë, në strukturat e MPJ-së që nuk përfitojnë gradë diplomatike. Koha e emërimit në këtë pozicion nuk llogaritet për efekt të vijimësisë së karrierës diplomatike.

2. Nëpunësit civilë që punojnë në strukturat e MPJ-së që nuk përfitojnë gradë diplomatike mund të aplikojnë për pozicionet e lira në strukturat e MPJ që përfitojnë gradë diplomatike nëse plotësojnë kriteret e pikës 2 të seksionit 3 dhe nëse kalojnë me sukses testimin e pranimit në sistemin e karrierës diplomatike. Në rastin e emërimit në këtë pozicion nëpunësi përfiton gradën diplomatike “Atashe”.

## KREU VII

EMËRIMI DHE MBARIMI I DETYRËS NË  
MISIONE DIPLOMATIKE DHE POSTE  
KONSULLORE

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si rregull, bën planin njëvjeçar të emërimeve /mbarimit të detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore dhe ia paraqet për vlerësim sekretarit të Përgjithshëm, jo më vonë se data 15 dhjetor e çdo viti.

2. Sekretari i Përgjithshëm i paraqet për miratim ministrit, jo më vonë se data 10 janar e çdo viti, planin e emërimeve/mbarimit të detyrës në misionet diplomatike/postet konsullore.

3. Ministri miraton, brenda muajit janar, planin e emërimeve/mbarimit të detyrës në misionet diplomatike/postet konsullore.

4. Pas miratimit të planit nga ministri, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në konsultim me drejtorinë që mbulon misionin diplomatik/postin konsullor ku krijohet vendi i lirë, përgatit të dhënat dhe kushtet specifike për plotësimin e tij dhe, brenda datës 15 shkurt të çdo viti, bën shpalljen për plotësimin e vendeve të lira.

  - të sigurojë se ndërtimi dhe shfrytëzimi i këtij objekti jep kontribut në reduktimin e emetimeve të gazrave të efektit serë dhe nuk ka ndikime të rëndësishme negative në mjedis;
  - të garantojë një përdorim racional të tokës dhe kthimin e saj në gjendjen fillestare, pas përfundimit të veprimtarisë prodhuese të objektit;
  - të sigurojë efikasitet të energjisë;
  - të përdorë teknikat më të mira, të disponueshme, që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes.

Neni 9

**Të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike, sipas tipit të burimit gjenerues të energjisë elektrike**

Një aplikues paraqet në ministri, në varësi të tipit të burimit gjenerues të propozuar, përveç sigurisë për plotësimin e kriterëve të shprehura në pikën 2, të nenit 8, të këtyre rregullave, edhe të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike të mëposhtme:

- A. Për një termocentral (TEC):
- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë (me cikël të thjeshtë, me cikël të kombinuar etj.) dhe parametrat teknikë të pajisjeve kryesore (kaldaja, turbina, motorë me djegie të brendshme, gjeneratorë, transformatorë);
  - llojin e lëndës djegëse që përdor;
  - efikasitetin termike, elektrike dhe totale të burimit gjenerues të energjisë;
  - konsumin specifik të lëndës djegëse;
  - fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
  - burimet e furnizimit me lëndë djegëse;
  - respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo



komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

B. Për një burim gjenerues të prodhimit të kombinuar të energjisë elektrike dhe nxehtësisë (me koogjenerim):

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë;
- llojin e lëndës djegëse;
- eficientën termike, elektrike dhe totale të burimit gjenerues të energjisë;
- konsumin specifik të lëndës djegëse;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- kapacitetin termik dhe elektrik të burimit gjenerues të energjisë;
- destinacionin e nxehtësisë së prodhuar;
- kapacitetin termik të kaldajës mbështetëse, nëse ka;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

C. Për një gjenerues me erë:

- të dhëna për potencialin e erës në zonën e propozuar;
- shpejtësinë minimale dhe maksimale të shfrytëzueshme të erës;
- shpejtësinë mesatare vjetore të erës;
- tipin dhe lartësinë e kullës eolike;
- diametrin e rotorit të gjeneruesit;
- numrin e kullave, nëse do të jetë një park eolik;
- respektimin e normave mjedisore akustike dhe vizuale;

- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

Ç. Për një sistem fotovoltaik:

- karakteristikat teknike të sistemit fotovoltaik;
- rrezatimin diellor mesatar vjetor, të vendit ku do të ndërtohet sistemi, [kJ/m<sup>2</sup> në vit];
- këndin optimal të përthyerjes, të panelit diellor;
- sipërfaqen, në metra katrorë, të panelit të instaluar;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

D. Për një burim gjenerues me biomasë:

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë elektrike;

- llojin e biomasës;
- konsumin specifik të lëndës djegëse biomasë;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- mënyrën e sigurimit dhe furnizimit me biomasë;

- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

DH. Për një vetëprodhues mbi 1 MW:

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë;
- llojin e lëndës djegëse;
- konsumin specifik të lëndës djegëse;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- sasinë e prishme të energjisë elektrike, që do të konsumohet për nevojat e tij vetjake;
- sasinë e prishme të energjisë elektrike, që do të absorbohet ose injektohet në rrjetin kombëtar;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

Neni 10

### Studimi i parafisibilitetit

1. Aplikuesi, në përputhje me pikën 8, të këtij vendimi, paraqet një studim parafisibiliteti, që jep besueshmëri të mjaftueshme teknike, ekonomike dhe financiare të projektit të propozuar, si dhe ndikimin e tij mjedisor dhe social.

2. Studimi i parafisibilitetit, i paraqitur sipas pikës 1, të këtij neni, përfshin:

a) Në terma teknike, studimi duhet të japë informacion lidhur me besueshmërinë teknike të projektit të propozuar dhe duhet të shoqërohet me paraqitjen e përgjithshme skematike të burimit gjenerues të energjisë; një diagram elektrik të agregateve dhe bllokut të transformimit, ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes; opinionin paraprak të OST-së ose OSHEE-së mbi lidhjen e tij me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes së energjisë elektrike; shtrirjen gjeografike të vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprim-taria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë, me shkallë 1:25 000; një hartë topografike, ku të paraqitet gjurma e linjës që lidh burimin gjenerues me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes, në shkallë 1:25 000.



b) Në terma ekonomike, studimi duhet të paraqesë një plan biznesi, që demonstroi besueshmërinë ekonomike të projektit të propozuar. Plani i biznesit duhet të përcaktojë, minimalisht, shpenzimet dhe të ardhurat e pritshme si dhe kohëzgjatjen e periudhës së ndërtimit, në muaj. Kostot duhet të ndahen në kategoritë përkatëse: kostot financiare, kostot e ndërtimit (përfshirë kostot lidhur me fuqinë punëtore, makineritë dhe lidhjen me rrjetin), kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.

c) Në terma financiare, studimi duhet të paraqesë një plan financiar që demonstroi besueshmërinë financiare të projektit të propozuar. Plani financiar duhet të përcaktojë, në mënyrë të qartë dhe transparente, se si synon aplikuesi të financojë projektin e propozuar. Ai duhet të përcaktojë, minimalisht, sasinë e alokuar të kapitalit të vet, ndaj burimeve financiare të jashtme të kërkuara, burimet konkrete të financimit nga jashtë dhe një program të detajuar financimi. Aplikuesi duhet të paraqesë dokumente, në formën e një letre interesi, marrëveshje paraprake kreditimi ose çdo dokument tjetër, që vërtetojnë mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase apo të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione apo financime të tjera).

ç) Në terma të impaktit mjedisor dhe social, studimi duhet të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor dhe social të projektit të propozuar. Aplikuesi duhet të sigurojë informacion lidhur me ndikimin pozitiv ose negativ të projektit mbi përdorimin e tokës, biodiversitetin dhe peizazhin, efektet lidhur me ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, emetimin e gazrave në atmosferë, tokë ose ujë, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social të projektit, si p.sh. ato për punësimin lokal, përmirësimin e infrastrukturës ose çdo ndikim tjetër të rëndësishëm mjedisor ose social. Studimi mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis duhet të bazohet në legjislacionin në fuqi.

Neni 11

#### **Aplikimi nga një bashkim shoqërisht**

1. Aplikimi për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë mund të bëhet edhe nga më

shumë se një person, në formën e një bashkimi shoqërisht.

2. Në rast se një aplikim është paraqitur nga një bashkim shoqërisht, anëtarët e këtij bashkimi caktojnë një partner udhëheqës, i cili është i autorizuar, nëpërmjet një prokure, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e bashkimit, për të vepruar në emër të tyre, për qëllimin e aplikimit.

3. Dokumentet e përcaktuara në nenin 7, të këtyre rregullave, duhet të paraqiten për të gjithë anëtarët e bashkimit të shoqërisht.

Plotësimi i kriterëve financiarë dhe atyre teknike do të kërkohej në raport të pjesëmarrjes së shoqërive në bashkimin e shoqërive.

4. Ministria kërkon, në këtë rast, dokumentacionin e nevojshëm për përgjegjësinë solidare të bashkimit të përkohshëm të shoqërive, për realizimin e projektit.

Neni 12

#### **Shqyrtimi i dokumenteve të aplikuesit**

1. Ministria shqyrton nëse dokumentet e depozituara nga aplikuesi janë në përputhje me kërkesat e këtyre rregullave.

2. Ministria mund të verifikojë besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve.

3. Ministria i komunikon aplikuesit ose të deleguarit përgjegjës të tij, brenda 20 ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së aplikimit, pranimin e tij, nëse dokumentet dhe informacioni i paraqitur nga aplikuesi janë të plotë dhe në përputhje me kërkesat e neneve 7, 8, 9 e 10, të këtyre rregullave.

Neni 13

#### **Paraqitja e dokumentacionit të munguar**

1. Në rastet kur në aplikim mungon ndonjë nga dokumentet ose informacionet e parashikuara në nenet 7, 8, 9 e 10, të këtyre rregullave, Ministria i kërkon aplikuesit të paraqesë dokumentacionin e munguar, brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit për plotësimin e tij.

2. Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e munguar brenda periudhës së specifikuar në pikën 1, të këtij neni, Ministria refuzon aplikimin dhe kthen mbrapsht dokumentacionin.



## Neni 14

**Mbivendosja e vendndodhjeve të aplikimeve**

1. Në rast se për të njëjtën vendndodhje paraqiten dy ose me shumë aplikime, Ministria merr në shqyrtim aplikimin e paraqitur të parin në kohë.

2. Ministri njofton aplikuesit e tjerë për refuzimin e aplikimeve të tyre.

## Neni 15

**Publikimi i aplikimit**

1. Kur aplikimi pranohet, Ministria publikon tri ditë me radhë, në faqen e *website*-it të ministrisë, një njoftim me përmbajtjen e mëposhtme:

- një prezantim të shkurtër të aplikuesit;
- një përshkrim të shkurtër të projektit të propozuar;
- informacionin se ku mund të gjendet nga publiku aplikimi i detajuar;
- adresën e Ministrisë, ku mund të dërgohen objeksionet ose komentet lidhur me aplikimin;
- afatin për dërgimin e objeksioneve ose komenteve në ministri.

2. Ministria siguron që aplikimi dhe të gjitha dokumentet shoqëruese, si dhe çdo informacion tjetër, të jenë të disponueshme për konsultim publik, në mjediset e saj.

3. Ministria, duke marrë në konsideratë kërkesën e aplikuesit, mund të vendosë se cilat dokumente ose të dhëna të veçanta do të mbahen konfidenciale dhe mund të ndalojë njohjen e tyre nga publiku.

## Neni 16

**Objeksionet**

1. Çdo person, që ka një interes ligjor, mund të paraqesë, brenda 15 ditëve nga data e publikimit, sipas pikës 1, të nenit 15, të këtyre rregullave, në Ministri, objeksionet e tij lidhur me një aplikim të bërë.

2. Ministria informon aplikuesin për objeksionet që mund të ketë marrë, lidhur me aplikimin e tij, dhe kërkon sqarime nga aplikuesi për objeksionet e bëra, brenda 15 ditëve kalendarike.

3. Ministria nuk merr në konsideratë asnjë objeksion, nëse është bërë më vonë se afati i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

## Neni 17

**Komisioni i vlerësimit të aplikimit**

1. Aplikimi merret në shqyrtim dhe fillon të vlerësohet vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar në nenin 16, të këtyre rregullave, për paraqitjen e objeksioneve.

2. Ministri, për vlerësimin e një projekti të propozuar, krijon një komision vlerësimi me specialistë për ekspertizën e nevojshme teknike, ekonomike dhe juridike, të përbërë prej 7 anëtarësh. Kryetar i komisionit caktohet njëri prej drejtuesve të lartë të ministrisë.

3. Nëse, për vlerësimin e një propozimi, kërkohet ekspertizë e veçantë, mund të caktohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të aplikimit edhe specialistë nga institucione të tjera.

4. Komisioni, në procesin e vlerësimit të një aplikimi, nëse e konsideron të nevojshme, mund të kërkojë ekspertizë dhe konsultë të huaj, shpenzimet e të cilave do të përballohen nga aplikuesi.

5. Ministri nxjerr një urdhër për krijimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit të aplikimit.

## Neni 18

**Vlerësimi i aplikimit**

Komisioni i vlerësimit të aplikimit merr në shqyrtim aplikimin, lidhur me:

- a) aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare të aplikuesit;
- b) sigurimin e stafit të aftë dhe kompetent;
- c) strategjinë kombëtare të energjisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, ose ndonjë dokument tjetër të politikave energjetike për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë;
- ç) rendimentin e burimit gjenerues të energjisë;
- d) plotësimin e kushteve dhe standardeve mjedisore, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) vendndodhjen gjeografike të burimit gjenerues të energjisë, përkundërt sistemit të përgjithshëm kombëtar të prodhimit dhe furnizimit me energji;
- e) interferimin e burimit të ri gjenerues me shfrytëzimin e burimeve gjeneruese ekzistuese ose të atyre burimeve gjeneruese që janë autorizuar ose që janë në procesin e ndërtimit;
- ë) nëse karakteristikat e burimit të ri gjenerues të energjisë sigurojnë koordinim të përshtatshëm me sistemin elektroenergjetik;



f) zgjidhjen teknike të lidhjes së burimit gjenerues të energjisë me rrjetet e transmetimit ose shpërndarjes;

g) objeksionet e paraqitura lidhur me aplikimin, sipas nenit 16, të këtyre rregullave;

gj) sasinë e energjisë elektrike, (por jo më të vogël se 2% të sasisë vjetore të prodhimit ose konvertimin e saj në vlerë), që do të jepet falas, në formë *royalty*, ministrisë. Në rast konvertimi në vlerë monetare, këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit.

Neni 19

### Miratimi paraprak për vazhdimin e procedurave

1. Komisioni i vlerësimit të aplikimit i paraqet ministrit, brenda 45 ditëve nga marrja e aplikimit, sipas pikës 1, të nenit 17, të këtyre rregullave, një raport lidhur me miratimin ose refuzimin e aplikimit.

2. Ministri, në rast të një raporti pozitiv të komisionit të vlerësimit të aplikimit, i lëshon aplikuesit një miratim paraprak për vazhdimin e procedurave për marrjen e të drejtës së ndërtimit.

3. Miratimi paraprak për vazhdimin e procedurave përmban:

a) emrin e aplikuesit;

b) të drejtën ekskluzive të aplikuesit për të bërë matje ose studime të tjera, lidhur me investimet për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë;

c) periudhën kohore brenda së cilës aplikuesi duhet të përfundojë matjet ose studimet e tjera, lidhur me investimin, sipas shkronjës “b”, të kësaj pike, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 20.

4. Ministri, në rast të një vendimi negativ, njofton aplikuesit për refuzimin e aplikimit, duke dhënë argumentimin përkatës për arsyet e këtij vendimi.

5. Aplikuesi, të cilit i është refuzuar aplikimi, ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 20

### Paraqitja e dokumenteve të tjera

Aplikuesi, i pajisur me miratimin paraprak, sipas pikës 2, të nenit 19, të këtyre rregullave, i paraqet Ministrisë, brenda periudhës kohore të përcaktuar në miratimin paraprak, me qëllim marrjen e miratimit përfundimtar, sipas shkronjës “c”, të

pikës 3, të nenit 19, të këtyre rregullave, dokumentet e mëposhtme:

a) studimin e plotë të fisibilitetit teknik, ekonomik, financiar, mjedisor e social, bazuar në të dhëna dhe matje reale, të kryera në zonat e zbatimit të projektit;

b) planin e biznesit të projektit;

c) grafikun e zbatimit të projektit;

ç) miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes;

d) lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

dh) dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi truallin që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues.

Neni 21

### Dhënia e miratimit për ndërtim

1. Komisioni shqyrton, brenda 20 ditëve kalendarike, nga dita e paraqitjes, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha dokumenteve të paraqitura nga aplikuesi, sipas nenit 20, të këtyre rregullave.

2. Ministri, nëse arrin në përfundimin se të gjitha dokumentet e paraqitura nga aplikuesi, sipas nenit 20, të këtyre rregullave, janë të plota dhe të sakta, i dërgon Këshillit të Ministrave propozimin për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese mbi 2 MW, të cilat nuk janë objekt koncesioni.

Neni 22

### Përmbajtja e miratimit të ndërtimit

Miratimi për ndërtim kapacitetesh të reja prodhuese, i Këshillit të Ministrave, sipas nenit 21, të këtyre rregullave, përfshin elementet e mëposhtme:

a) emrin dhe selinë e mbajtësit të miratimit;

b) të drejtën e dhënë nga miratimi (tipin, kapacitetin dhe teknologjinë e burimit gjenerues të energjisë);

c) vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë;

ç) afatin e miratimit të ndërtimit;

d) afatin për përgatitjen e projektit të zbatimit teknik;

dh) të drejtën e institucioneve kompetente shtetërore për të mbikëqyrur dhe monitoruar veprimtarinë e ndërtimit të mbajtësit të miratimit;



e) detyrimin që mbajtësi i miratimit të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë, informacion mbi ecurinë e ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë;

ë) çdo kufizim, lidhur me mbrojtjen e natyrës;

f) detyrimin që ndërmjet aplikuesit dhe ministrisë të nënshkruhet një kontratë, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve mbi realizimin e këtij projekti dhe penalitetet, në rast mosrealizimi apo transferimi të miratimit, dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e projektit;

g) detyrimin e mbajtësit të miratimit, për pagesën e *royalty*, të shprehur nga aplikanti, sipas shkronjës “g”, të nenit 18, të këtyre rregullave;

gj) kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

### KAPITULLI III

## NDËRTIMI I BURIMEVE TË REJA GJENERUESE NËN 2 MW

### Neni 23

#### **Ndërtimi i objekteve të reja me kapacitet prodhues nën 2 MW**

Ndërtimi i objekteve të reja, që nuk janë objekt koncesioni dhe kanë kapacitet prodhues nën 2 MW, bëhet me miratim të ministrit.

Për dhënien e miratimit për objektet e reja, që nuk janë objekt koncesioni dhe kanë kapacitet prodhues nën 2 MW, zbatohen procedurat e parashikuara në nenet 4 deri 22, të këtyre rregullave, por me afate të përgjysmuara.

### Neni 24

#### **Të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike për ndërtimin e hidrocentraleve**

1. Në momentin e aplikimit për ndërtimin e një hidrocentrali, aplikuesi paraqet në Ministri, përveç sigurisë për plotësimin e kriterëve, të shprehura në pikën 2, të nenit 8, të këtyre rregullave, edhe të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike të mëposhtme:

a) zgjidhjen teknike, për një shfrytëzim maksimal të potencialit ujor, ku të përcaktohet fuqia e instaluar e projektuar e centralit dhe energjia mesatare vjetore që mendohet të prodhohet;

b) mënyrën e operimit të HEC-it;

c) informacionin e marrë nga këshilli i basenit ujor të zonës ku do të zbatohet projekti, për

prioritetin dhe për sasinë e ujit që mund të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike.

2. Pas marrjes së miratimit paraprak, sipas procedurave të parashikuara në nenet 10-19, aplikuesi i paraqet ministrisë, brenda periudhës kohore të përcaktuar në miratimin paraprak, me qëllim marrjen e miratimit përfundimtar, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 19, të këtyre rregullave, dokumentet e mëposhtme:

a) studimin e plotë të fisibilitetit teknik, ekonomik, financiar, mjedisor e social, bazuar në të dhëna dhe matje reale, të kryera në zonat e zbatimit të projektit;

b) planin e biznesit të projektit;

c) grafikun e zbatimit të projektit;

ç) miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes;

d) lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

dh) studimin gjeologjik;

e) studimin hidrogeologjik;

ë) oponentin nga organet e specializuara mbi projektin e propozuar;

f) lejen e përdorimit të ujit, nga këshilli i basenit ujor të zonës ku do të zbatohet projekti;

g) dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi truallin që do të përdoret për ndërtimin dhe operimin e burimit gjenerues.

### Neni 25

#### **Dhënia e miratimit për ndërtim për objektet nën 2 MW**

1. Ministri, nëse arrin në përfundimin se të gjitha dokumentet e paraqitura nga aplikuesi, sipas këtyre rregullave, janë të plota dhe të sakta, miraton ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese nën 2 MW, të cilat nuk janë objekt koncesioni.

2. Miratimi i ministrit përmban elementet e përcaktuara në nenin 22, të këtyre rregullave.





KAPITULLI IV  
TË DREJTA DHE DETYRIME PËR  
MBAJTËSIN E TË DREJTËS SË  
NDËRTIMIT

Neni 26

**Detyrimi për dhënien e informacionit**

1. Mbjajtësi i miratimit i dërgon ministrisë, çdo 3 (tre) muaj, nga data e miratimit të ndërtimit, një raport mbi veprimtaritë e tij për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

2. Ministria, pa u kufizuar nga pika 1, e këtij neni, ka të drejtë t'i kërkojë subjektit çdo informacion që e konsideron të nevojshëm, lidhur me zbatimin e miratimit të ndërtimit.

Neni 27

**Zgjatja e afatit të miratimit të ndërtimit**

1. Mbjajtësi i miratimit të ndërtimit mund t'i paraqesë ministrisë një kërkesë me shkrim për zgjatjen e afatit të ndërtimit, duke dhënë arsyet për zgjatjen e kërkuar.

2. Ministria, nëse e gjen të argumentuar, sipas rastit, miraton zgjatjen e ndërtimit ose, në rast të objekteve mbi 2 MW, vijon procedurat për propozimin e ndryshimit në Këshillin e Ministrave.

3. Në rast se Ministria nuk e gjen të argumentuar zgjatjen e afatit të ndërtimit, revokon të drejtën e ndërtimit ose i propozon Këshillit të Ministrave shfuqizimin e të drejtës së ndërtimit.

4. Çdo zgjatje e afatit të së drejtës së miratimit për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë, siç përcaktohet në pikën 1, të këtij neni, mund të jepet vetëm një herë dhe mund të jetë jo më e gjatë se gjysma e periudhës së ndërtimit.

Neni 28

**Transferimi i së drejtës për ndërtim**

1. E drejta për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një person i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e ministrit ose të Këshillit të Ministrave, sipas rastit të miratimit fillestar. Çdo transferim te të tretët, pa miratimin e ministrit apo të Këshillit të Ministrave, është i pavlefshëm.

2. Transferimi i të drejtës së ndërtimit nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së detyrimeve.

3. Subjekti që pajiset me të drejtën e ndërtimit duhet të plotësojë dhe të dorëzojë pranë ministrisë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 7, të këtyre rregullave.

Neni 29

**Heqja e miratimit**

1. Ministri ose Këshilli i Ministrave, në varësi të kapacitetit të instaluar, mund të vendosë për heqjen e miratimit të ndërtimit, në rastet e mëposhtme:

- me kërkesë me shkrim të mbajtësit të së drejtës, në raste të veçanta, të justifikuara;

- në rast se subjekti nuk ka plotësuar detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në aktin e miratimit;

- nëse nuk është zbatuar grafiku i punimeve dhe nëse brenda 30 ditëve, nga njoftimi që Ministria i bën aplikantit, ky i fundit nuk justifikon mosrealizimin e detyrës dhe nuk dokumenton mundësitë e tij për të përfunduar, në datën e përcaktuar, objektin ose ndonjë fazë të tij;

- nëse mbajtësi i tij nuk informon, siç kërkohet nga neni 26, i këtyre rregullave, dhe nëse brenda një afati prej 15 ditësh, pas njoftimit paraprak nga ministria, aplikuesi përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;

- nëse vërtetohet se deklaratimet e subjektit nuk janë të vërteta;

- kur, për mbajtësin e të drejtës së ndërtimit, kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi;

- kur mbajtësi i të drejtës së ndërtimit nuk plotëson detyrimin e përcaktuar në shkronjën "gj", të nenin 18.

2. Në çdo rast, heqja e të drejtës së ndërtimit argumentohet dhe i njoftohet subjektit.

KAPITULLI V  
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30

**Kopjet e miratimit**

1. Një miratim për ndërtim burimi gjenerues të energjisë elektrike, me kapacitetet mbi 2 MW, lëshohet në tri kopje, prej të cilave një kopje i bashkëngjitet dosjes së mbajtur në arkivin e Këshillit të Ministrave, një kopje e mban ministria dhe një kopje i jepet aplikuesit.

2. E drejta e ndërtimit për kapacitetet nën 2 MW lëshohet në dy kopje, një prej të cilave i bashkëngjitet dosjes së mbajtur në arkivin e ministrisë dhe një kopje i jepet aplikuesit.



Neni 31

**Dispozita kalimtare**

Çdo aplikim i bërë në ministri, për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni, mbi ose nën 2 MW, pas miratimit të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, trajtohet sipas dispozitave të këtyre rregullave.

## ANEKSI 1

**FORMAT APLIKIMI PËR NDËRTIMIN E  
NJË CENTRALI ELEKTRIK**

Ministria e Energjisë dhe Industrisë  
Sheshi “Skënderbej”, nr. 2,  
Tiranë  
Shqipëri

**P.O. Box (kutia postare) 1001**

Unë i nënshkruari ....., administrator i shoqërisë ....., përfaqësuar nga i deleguari im përgjegjës ....., në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe vendimit të nr....., datë..... “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni” aplikoj për ndërtimin e centralit elektrike .....

Aplikimi shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....
- 5.....
- 6.....
- 7.....
- 8.....
- 9.....
- 10.....
- 11.....
- 12.....
- 13.....
- 14.....
- 15.....

Administratori,  
**[Emër, mbiemër] [vula]**

## I. TË DHËNA PËR APLIKUESIN

1. Emri i plotë i aplikuesit .....
2. Adresa ose selia e aplikuesit .....
3. Numri i telefonit të aplikuesit .....
4. Numri i faksit të aplikuesit .....
5. I deleguari përgjegjës i aplikuesit (nëse ka)  
Emri  
Nr. i telefonit  
Nr. i faksit

6. Forma ligjore e aplikuesit .....

## II. TË DHËNA PËR CENTRALIN

1. Emri i centralit
2. Vendndodhja e centralit
3. Tipi i centralit elektrik (termo, hidro, ere, fotovoltaiq, biomas ose tjetër)
4. Data e pritshme e futjes në punë të centralit të propozuar
5. Kapaciteti i instaluar i plotë i centralit dhe për çdo njësi gjeneruese (MW)
6. Jetëgjatësia e pritshme e centralit

## III. INFORMACION SHITESË

Ju lutem jepni çdo informacion tjetër të rëndësishëm që aplikuesi dëshiron të përfshijë në këtë aplikim.

## ANEKSI 2

**VLERAT E PAGESAVE PËR APLIKIMET PËR  
MARRJEN E MIRATIMEVE PËR NDËRTIMIN E  
NJË CENTRALI ELEKTRIK**

	Kapaciteti i centralit	Vlera (në lekë)
1.	Deri në 2 MW	100 000
2.	2 MW – 10 MW	150.000
3.	10 MW - 100 MW	200 000
4.	Më i madh se 100 MW	300 000

Pagesat do të bëhen në numrin e llogarisë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë \_\_\_\_\_

**VENDIM**

**Nr. 823, datë 7.10.2015**

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË  
PRONËSISË SË DISA PARCELAVE  
NDËRTIMORE NË FAVOR TË  
POSEDUESVE TË OBJEKTEVE  
INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të nenit



163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Sipërfaqet maksimale, për të cilat miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën e ndërtimit pa leje, të jenë sipas listës emërore dhe evidencës që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Numri i parcelave ndërtimore dhe sipërfaqja e përgjithshme e truallit për secilin qark janë, si më poshtë vijon:

a) Qarku Fier, 70 (shtatëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 21 219 (njëzet e një mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) m<sup>2</sup>;

b) Qarku Tiranë, 78 (shtatëdhjetë e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 17 762 (shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) m<sup>2</sup>;

c) Qarku Vlorë, 45 (dyzet e pesë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 12 574 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) m<sup>2</sup>;

ç) Qarku Gjirokastrë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 597 (pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>;

d) Qarku Dibër, 38 (tridhjetë e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 744 (nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër) m<sup>2</sup>;

dh) Qarku Shkodër, 72 (shtatëdhjetë e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 16 637 (gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>;

e) Qarku Elbasan, 25 (njëzet e pesë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 7 474 (shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër)

m<sup>2</sup>;

ë) Qarku Berat, 4 (katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 300 (një mijë e treqind) m<sup>2</sup>;

f) Qarku Korçë, 23 (njëzet e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 886 (dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë) m<sup>2</sup>;

g) Qarku Lezhë, 38 (tridhjetë e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 518 (nëntë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) m<sup>2</sup>;

gj) Qarku Durrës, 28 (njëzet e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 684 (nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) m<sup>2</sup>;

h) Qarku Kukës, 48 (dyzet e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 13 985 (trembëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>.

3. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesit e ndërtimeve pa leje.

4. Deri në momentin e regjistrimit të ndërtimit të legalizuar, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të mos kryejnë ndryshime të gjendjes juridike të pasurive të listuara në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE  
TË DHËNAT SIPAS LISTËS EMËRORE PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSË

Nr. rendor	DREJTORIA	Të dhënat e vetëdeklaruesit				Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e parcelës m <sup>2</sup>	Lloji i pronësisë
		Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. i prot. të vetëdeklarimit				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	13
1	FIER	LAMI	LLAZI	KOLA	1073	8532	3/1332	225	shtet
2	FIER	FATMIR	TAJAR	GREMI	1562	8532	8/1257	320	shtet
3	FIER	ANDON	VANGJEL	KOCO	1384	8532	8/1258	280	shtet
4	FIER	GEZIM	SYBI	VELIU	7820	8532	8/1259	311	shtet
5	FIER	ILIR	RIZA	DRIZA	54	8532	8/1260	316	shtet
6	FIER	MIRANDA	LILI	PRIFTI	838	8532	8/1261	341	shtet
7	FIER	ADRIAN,TOMI, NERITAN	SKENDER	COBO	745	8532	9/1311	500	shtet
8	FIER	AMDI	OSMEN	SHATERI	441	8532	9/1317	399	shtet
9	FIER	GJEK	NASI	MECO	1413	8532	9/1327	214	shtet
10	FIER	ALEKSANDER	NDREK	PRIFTI	822	8532	9/1328	296	shtet
11	FIER	YLLI	SHYQYRI	BALLIU	682	8532	9/1329	344	shtet
12	FIER	GEZIM, GENTIAN, ERION	SALI	AGALLIU	17225	8532	9/1330	205	shtet
13	FIER	TAHIRE	REFAT	BALLIU	843	8532	9/1331	254	shtet
14	FIER	YLLI	TEFIK	CEPELJA	7694	8532	9/1332	261	shtet
15	FIER	MIKAIL	LEKO	RAMA	16752	8532	9/1333	240	shtet
16	FIER	SOKRAT	LONI	NDINI	11132	8532	9/1334	155	shtet
17	FIER	KOSTANDIN	NDREK	PRIFTI	15533	8532	9/1335	339	shtet
18	FIER	YMER NURI	MUHAMET RIZA	GREMBI YZEIRAJ	2729	8532	9/1336	261	shtet
19	FIER	MYEDIN	XHEVTI	ASLLANAJ	18550	8532	9/1337	261	shtet
20	FIER	MIKAIL	JORGJI	SOTA	446	8532	10/1000	306	shtet
21	FIER	NAZIF	JASHAR	AZGJENI	FR14280MB	2944	9/356	397	shtet
22	FIER	AGIM	REFAT	GREMAJ	16328	2944	27/300	388	shtet
23	FIER	GEZIM	ISMET	MAKA	FR14355MB	2944	35/354	429	shtet
24	FIER	PAVLI	MITI	KOROVESHI	FR14420MB	2944	38/300	156	shtet
25	FIER	PERO	XHEMAL	HALLA	17313	2944	59/350	306	pronar
26	FIER	DURIM	QEMAL	METAJ	FR14376MB	2944	62/356	298	shtet
27	FIER	ASTRIT	JONUS	LIKA	FR14366MB	2944	66/400	367	pronar+shtet
28	FIER	FERDINANT	HAJDAR	RABIJA	1054	2944	66/403	295	shtet
29	FIER	VEIZ	KARAFIL	HEBEJA	6286	2944	66/406	123	shtet
30	FIER	HAMIT	GANI	BULLA	3875	2944	70/406	428	shtet
31	FIER	ARDJAN	GANI	BULLA	11916	2944	70/409	303	shtet
32	FIER	DRITAN	SHEFKI	MAKA	12175	2944	74/400	397	pronar
33	FIER	VALENTINA	JASHAR	PETOVA	FR14356MB	2944	91/404	313	shtet
34	FIER	RAMADAN	TARE	GREMI	FR14353MB	2944	91/406	300	shtet
35	FIER	PERPARIM	ISMAL	TAFA	FR14332MB	2944	93/350	353	shtet
36	FIER	PELLUMB	MYSLYM	SENKA	FR14394MB	2944	108/304	315	shtet
37	FIER	HEKURAN	RAMAZAN	RAKIPI	FR14386MB	2944	118/308	321	pronar+shtet
38	FIER	FATMIR	SALI	DOSTI	18	2497	17/300	312	shtet
39	FIER	DULE	NURCE	SHUSHA	7	2497	25/300	339	shtet
40	FIER	ANDREA	FECOR	MERAJ	112	2497	28/300	322	shtet+pronar
41	FIER	HAREDDIN	MALO	SHUSHA	13	2497	28/301	365	pronar
42	FIER	DANE	QAZIM	HOXHA	305	2497	89/300	275	shtet
43	FIER	FESTIM	SULEJMAN	VELMISHI	241	2497	122/300	254	shtet
44	FIER	SULEJMAN	RAPUSH	VELMISHI	236	2497	122/301	254	shtet
45	FIER	IBRAHIM	RAPUSH	VELMISHI	232	2497	128/300	398	shtet
46	FIER	LUAN	IBRAHIM	VELMISHI	233	2497	128/303	319	shtet+pronar
47	FIER	BUJAR	RRAPUSH	COBO	181	2497	135/300	71	pronar
48	FIER	PELLUMB	LATIF	DUKA	177	2497	140/300	469	shtet
49	FIER	MEHMET	SALI	MENKA	227	2497	162/300	415	shtet
50	FIER	HAJDAR	HYSEN	REXHHA	82	2497	207/350	77	shtet
51	FIER	BEQAR	NURI	HOXHA	86	2497	207/351	357	shtet
52	FIER	FETI	HYSEN	REXHHA	73	2497	207/352	329	shtet+pronar
53	FIER	ZYBER	HYSEN	REXHHAJ	83	2497	207/362	310	shtet
54	FIER	MEHMET	BEQIR	ELMAZAJ	69	2497	207/363	412	shtet
55	FIER	MUHARREM	KARAFIL	DREKA	115	2497	219/300	442	shtet+pronar
56	FIER	MYNYR	QEMAL	DREKA	64	2497	219/301	447	shtet+pronar
57	FIER	FATMIR	HEKURAN	DREKA	62	2497	225/300	402	shtet
58	FIER	ARJAN	SEFRET	MINA	80	2497	237/300	57	pronar
59	FIER	ARIF	HYSEN	REXHHAJ	85	2497	237/301	253	shtet



60	FIER	FESTIM	QERIM	TOSKA	110	2497	253/300	444	shtet
61	FIER	GEZIM	QERIM	TOSKA	109	2497	254/300	279	shtet
62	FIER	NAZIF	RAMIS	ZEQIRAJ	133	2497	274/200	61	shtet
63	FIER	AGRON	ZYBER	MADHI	150	2497	274/203	315	shtet
64	FIER	FETAH	RAMS	DALIPAJ	168	2497	283/300	359	pronar
65	FIER	AQIF	DANE	KERRI	264	2497	331/300	500	shtet
66	FIER	KADRI	MYSTEHAK	TROKA	FR27721LE	2436	195/300	500	shtet
67	FIER	MYNYR	MYSTEHAK	TROKA	FR27704LE	2436	226/500	374	shtet
68	FIER	QEMAL	LAME	HASANI	17776	1634	50/200	74.2	shtet
69	FIER	VIKTOR	REFAT	BEGAJ	75	1811	90/100	74.1	pronar
70	FIER	KRISTAQ	KOLI	BERDALLI	227	8533	3/1150	43	shtet
71	TR-2	MIRANDA	RAMADAN	XHOLI	313	8350	1/530	22.40	pronar
72	TIRANA 2	KADRIJE	REXHEP	MERXHUSHI	2153	8340	7/611	34.3	shtet
		ARJAN	MENTOR	HYSEN LARI	81				
		ASTRIT	DALIP	SULOZEQAJ	2149				
		ANA	DALIP	SULOZEQAJ	2149				
		HAVA	SADIK	SULOZEQAJ	2149				
		HEDIJE	SABRI	DEMIRAJ	2152				
		ZENE	OSMAN	LAMAJ	2150				
		TAULANT	RAMAZAN	LAMAJ	2150				
GAZMEND	OSMAN	LAMAJ	2150						
73	TIRANA 2	FATOS	SHAQIR	BRUZJA	2811	8340	7/610	17.5	shtet
		GERTIAN	VELO	VELO	714				
74	TIRANA 2	HAJRIJE	BAJRAM	ÇOKU	2327	8180	5/270	7.5	shtet
		SHADIJE	BAJRAM	ARAPI					
		BUKURIJE	SHEFKI	LENGA					
		VIOLETA	ISLAM	MURATI					
75	TIRANA 2	AFERDITA	KALEM	KOVAÇI	1273	8350	1/533	29	pronar
		FIQRET	REXHEP	MEMA					
		ROLAND	SEIT	MEMA					
76	TIRANA 2	FIQRET	REXHEP	MEMA	3	8140	1/978	39.4	shtet
		PETRIT	SELMAN	BARDHOSHI					
		ARBEN	MANE	HUSI					
		SHABAN	IBRAHIM	DINE					
77	TIRANA 2	FATOS	SAMI	HADERI	793	8190	8/991	150.00	shtet
		DHIMITER	KOSTA	KONOMIS					
		FATMIRA	IBRAHIM	HAJDARAJ					
		KIRJALD	AZEM	HAJDARAJ					
78	TIRANA 2	RUDINA	AZEM	HAJDARAJ	2471	8120	4/305	71.70	shtet
		AZEM	AZEM	HAJDARAJ					
		AGIM	MEXHID	NELA					
79	TIRANA 2	JULIAN	EQEREM	KATROSHI	1780	8310	8/920	13.80	shtet
		ROZANA	EQEREM	KATROSHI					
80	TIRANA 2	ADRIAN	ANASTAS	KONDO	320	8270	2/642	101.90	shtet
		GERTIAN	LUFIT	HONHAJ					
		PASHUK	YLLI	MASMALAJ					
81	TIRANA 2	NIKOLL	PAL	LESI	4007	8270	2/796	48.60	shtet
		NATANA	GJON	LESI					
82	TIRANA 2	BLENDAR	SYRJA	LLAPI	1087	8210	6/500	34.40	shtet+pronar
		RIZA	SKENDER	NELAJ					
83	TIRANA 2	ARJAN	RAKIP	DERVISHI	1310	8350	1/534	131.60	pronar
		RIZA	SKENDER	NELAJ					
		FLORESHA	FERIT	LAZE					
		ORNELA	ILIR	LAZE					
		ANISA	ILIR	LAZE					
		ZYLHA	TALO	SULEJMANI					
		BUJAR	ASLLAN	SHAHINI					
		HIQMET	XHELO	MELLAS					
		XHILDA	ANTONIN	TUPJA					
		MARK	NDUE	LULI					
		MARK	NDUE	LULI					
84	TIRANA 2	ARJAN	PILO	GJINI	816	8350	2/671	44.4	shtet+pronar
		SKENDER	XHELAL	LARAKU					
		ASTRIT	SADIK	RAMA					
		AGIM	MUHARREM	DOKU					
85	TIRANA 2	ARTAN	HYSEN	VILA	990	8350	2/670	47.4	shtet+pronar
		GAZMEND	NJAZI	BESHI					
		FLORA	AQIF	SINANI					
		AGRON	AQIF	SINANI					
		MAJLINDA	AQIF	MYRTAJ					
		ANILA	ISLAM	SINANI					
		REANA	REFAT	SINANI					
		VLASH	KOSTANDIN	MARA					
THOMA	MINA	DHAME							
86	TIRANA 2	ANGJELIN	NDOC	PRENDI	930/797	8380	7/500	77.1	pronar
		ARTA	JANAQ	JICA					
87	TIRANA 2	FESTIM	RAMIZ	HAZIZAJ	117	8180	2/383	20.90	shtet
		LEONARD	EMRULLA	XHAMANI					
		VELISHA	AVNI	ALIÇKA					
		AGRON	DAUT	ESTI					
		HALIL	HAMDI	KUÇI					



88	TIRANA 2	ARTUR	GJERGJ	ZAJSI	Y-3679	8260	1/500	46.00	shtet
89	TIRANA 2	VIKTOR	LUSH	HYSAJ	692	8170	6/136	240.2	shtet
90	VLORE	PAJTIM	RAMO	MANOLAJ	782/1	8601	31/296	276	shtet
91	VLORE	BESNIK	ARSHI	TROKA	455/1	8601	26/96	171	shtet
92	VLORE	MONDI	MUHARREM	SKENDERAJ	851/1	8601	25/307	156	shtet
93	VLORE	SOTIR	HEKURAN	BELAJ	1345/1	8601	29/327	243	shtet
94	VLORE	DEMIR	BEKTASH	KAPILLANAJ	290/1	8601	18/454	327	shtet
95	VLORE	JORGO	HARITO	DADO	293/1	8601	18/455	392	shtet
96	VLORE	ALBAN	PELLUMB	BINAJ	702/1	8601	28/106	130	shtet
97	VLORE	VLADIMIR	LUTFI	HABILAJ	1420/1	8601	29/313	271	shtet
98	VLORE	DEMIR	REXHEP	DERVISHAJ	86/1	8601	27/413	280	shtet
99	VLORE	BUJAR	BEKTASH	LUZAJ	1352/1	8601	26/455	273	shtet
100	VLORE	KASTRIOT	SELAMET	LUSHAJ	901/1	8601	25/309	246	shtet
101	VLORE	ASTRIT	NJAZI	LIMAJ	589/1	8601	35/564	500	shtet
102	VLORE	GEZIM	HYSO	GUHACAJ	836/1	8601	35/209	321	shtet
103	VLORE	BESNIK	AGUSH	CACA	1182/1	8601	26/341	394	shtet
104	VLORE	ALFONS	LEFTER	DULAJ	1106/1	8601	19/658	233	shtet
105	VLORE	ARTUR	MAZAR	MEHMETI	1395/1	8601	19/351	285	shtet
106	VLORE	LAVDOSH	HARIZ	RAMADANI	1526/1	8601	4/396	261	p.p.v
107	VLORE	ORHAN	XHEMIL	JAHAJ	415/2	8601	28/375	273	shtet
108	VLORE	FIQIRI	BINO	KASAJ	2261/2	8602	9/389	288	pronar + shtet
109	VLORE	DENIS	ZILO	KORKAJ	2118/2	8602	4/380	25	shtet
		SERVETE	MUHAREM	BINO					
		LUAN	JAUP	BALILAJ					
		YLLI	IBRAHIM	BILANAJ					
110	VLORE	ENGJELLUSH	AHMET	MANÇAJ	6483	8602	18/526	20	shtet
111	VLORE	LUMTURI	HYSEN	KOCIRAJ	233/2	8602	10/338	400	shtet
		FADIOLA	PIRO	(KOÇIRAJ)NURAJ					
		FATJON	PIRO	KOÇIRAJ					
112	VLORE	FATMIR	IBRAHIM	BARDHI	405/2	8602	10/328	204	shtet
113	VLORE	MYZAFER	HAMZA	HAXHIAJ	32/4	8604	26/156	307	pronar
114	VLORE	ZAIM	RESHAT	BRESHANAJ	2495/5	8605	53/602	155	shtet + pronar
115	VLORE	LUAN	FASLLI	RAMAJ	914/5	8605	8/214	336	shtet
116	VLORE	AGRON	SADIK	VEIZAJ	285/5	8605	19/237	357	shtet
117	VLORE	SKENDER	NEXHIP	FETA	2854/5	8605	36/153	134	toke te vet+ shtet
118	VLORE	MELEQ	KUJTIM	DEMIRAJ	732/5	8605	8/236	366	shtet
119	VLORE	KRISTAQ	PALI	PAPA	1390/5	8605	8/207	44	shtet
120	VLORE	KRISTAQ	PALI	PAPA	1391/5	8605	8/255	306	shtet
121	VLORE	BEHARE	HASIM	PINDERI	942/5	8605	8/237	209	shtet
		DHIMITRAQ	HETEM	PINDERI					
		RAJMONDA	HETEM	PINDERI(RAMAJ)					
		ZHULJETA	HETEM	PINDERI(HAJDARASI)					
		FILLORETA	HETEM	PINDERI(LIKA)					
		NEXHMIJE	HETEM	PINDERI(ASANI)					
MAJLINDA	HETEM	LUMANI(PINDERI)							
122	VLORE	ENVER	AZBI	DERVISHI	1624/5	8605	36/13	327	shtet
123	VLORE	DRITAN	TEME	META	635/5	8605	28/015	243	pronar
124	VLORE	KUJTIM	ZAÇE	BRAHO	583/1	8605	18/250	336	shtet
125	VLORE	FATMIR, MUIM	RUSTEM	PASHAJ	1846/4	8605	15/160	500	shtet
126	VLORE	ZENEL	TAFIL	ÇUMANAJ	1048/5	8605	13/236	330	shtet
127	VLORE	NAZMI	NEKI	MULLAI	1083/5	8605	19/424	299	shtet
128	VLORE	ISLAM	NEKI	SHKEMBI	1262/5	8605	18/233	277	shtet
129	VLORE	SKENDER	SHABAN	KAJO	1020/5	8605	28/016	348	pronar
130	VLORE	BATO	SKENDER	KABASHA	595/5	8605	1/014	303	pronar
131	VLORE	SANIE	QEMAL	SOTA	293/5	8605	43/108	141	shtet
132	VLORE	GURI	NAZI	MEJDIAJ	2881/5	8605	50/321	287	shtet
133	VLORE	SELIME	BRAHIM	SINANI	1865	3621	754	500	shtet+ toke te vet
		SILVANA	SHERIF	SINANI					
		GAZMEND	SHERIF	SINANI					
134	VLORE	ALBANA	FAIK	PELVANI	1901	3621	754	500	shtet+ toke te vet
		GENTA	FAIK	SINANI					
		LIRI	BRAHIM	SINANI					
		ILIR	FAIK	SINANI					
135	TIRANA 1	XHELAL	MEXHIT	KALOSHI	277	8370	9/90	128	shtet
136	TIRANA 1	NDRIÇIM	VAHID	SHABA	784	2704	200/1491	317.3	pronar
137	TIRANA 1	SOKOL	ZEF	ULNDREAJ	545	8310	2/393	150.5	shtet
138	TIRANA 1	PETRIT	SHABAN	XHIXHA	4744	8320	3/827	315.6	shtet
139	TIRANA 1	VISJAN	SKENDER	DEDJA	4211	8330	1/733/1	414.5	pronar
140	TIRANA 1	AGRON	HAXHI	TOSKA	105	8120	9/1101	147.1	pronar
141	TIRANA 1	AGIM	QAZIM	DEMARMU	4654	8190	9/66	233.5	shtet
142	TIRANA 1	ESAT	MAHMUT	ALLMÛCA	1041	8190	15/901	120	shtet
143	TIRANA 1	ASTRIT	QERIM	KARAJ	3139	8230	3/737	300.2	shtet
144	TIRANA 1	ANDREA	MITAT	VASILIS	2433	2460	496/9	500	pronar
		ADRIATIK	MITAT	BEJKO					
145	TIRANA 1	FLORJAN	FIQIRI	XHIXHA	1329	8320	3/529/2	250.8	shtet
146	TIRANA 1	RIZA	RAMIZ	AHMETAJ	32, 1005	8110	3/341/1	293.7	shtet
147	TIRANA 1	FLAMUR	ISUF	BRAHJA	476	3266	400/1810	500	pa informacion
148	TIRANA 1	GEZIM	SELIM	HALA	2497	8110	6/462/1	162	shtet
149	TIRANA 1	SHAQIR	OSMAN	HASA	1735, 1900	8120	2/547	271.8	pronar + ppv
		BILBIL	SHAQIR	HASA					
150	TIRANA 1	HASAN	MERSIN	TUSHA	2527	8170	8/389	288.1	shtet



151	TIRANA 1	SHEFKI	MERSIN	TUSHA	2528	8170	8/388	96.3	shtet
152	TIRANA 1	IBRAHIM	MAHMUT	KOSTA	1060	3266	136/1334	300	shtet + pronar
153	TIRANA 1	BEKIM	XHELADIN	NIKOLLI	1284	8320	1/227/1	204.7	shtet
154	TIRANA 1	LORENC	AQIF	FYSHKU	2242	8340	9/902	150.5	shtet + pronar
155	TIRANA 1	NAIM	HYSEN	BRAMA	1084	2679	440/343	275.3	shtet + pronar
156	TIRANA 1	GUXIMIAR FATMIR	FAIK FAIK	MATJANI MATJANI	1964, 8	8120	8/784	357.2	ppv + pronar
157	TIRANA 1	ZENEL NDRICIM	MAHMUT MAHMUT	ZENELI ZENELI	125	3266	400/1312	300	pa informacion
158	TIRANA 1	GEZIM	NDOC	NDRECEPECAJ	3017	8310	1/429	64.05	shtet
159	TIRANA 1	BARDHYL	ASLLAN	ASLLANI	611	8340	8/373	82.9	shtet + pronar
160	TIRANA 1	ISUF	RAMADAN	POLIÇI	366	8110	6/544	500	shtet + pronar
161	TIRANA 1	ILIR	IDRIZ	ZENELAJ	1426	3266	13/1373	195.9	pronar
162	TIRANA 1	ASTRIT SHEFFQET YLLI HYQMET	HAKI HAKI HAKI HAKI	VODHA VODHA VODHA VODHA	2036	3976	111/653	246.3	shtet
163	TIRANA 1	ARTUR	MARASH	SUSAJ	4319	8170	3/444	420	pronar
164	TIRANA 1	ILIA LATIF	SOTIR RIZVAN	LEKA ABRASHI	626	2460	178/31	300	pronar
165	TIRANA 1	NDUE	HIL	MARVATAJ	280	8320	14/187	500	shtet
166	TIRANA 1	AGIM	MERSIN	TUSHA	2530	8170	8/390	182.6	shtet
167	TIRANA 1	HEKURAN	BEZAT	BEQIRI	1077	8190	4/805	337.6	pronar
168	TIRANA 1	FEIM	ALI	BIBA	876/05	8170	3/470	300	shtet + pronar
169	TIRANA 1	BAFTJAR	HYSEN	MURATI	1727	8330	3/951	27.5	pronar
170	TIRANA 1	AGIM	LULO	SKENDO	390	8260	6/2271	218.2	shtet
171	TIRANA 1	BUJAR	VAID	SHABA	1280	3266	200/1492	344.7	pronar
172	TIRANA 1	MANUSHAQE	HASAN	LAZRI	380	8270	8/702	383.5	pronar
173	TIRANA 1	NUREDIN	HYSEN	VATOÇI	3534	8240	1/375	300	shtet
174	TIRANA 3	ETLEVA RUZHDI	RAMAZAN BESIM	CELMETA CELMETA	2860	2951	262/10/1	300	shtet
175	TIRANA 3	SULEJMAN FLORENC ARDJANA ELSA	MERSIN SULEJMAN SULEJMAN SULEJMAN	GJATA GJATA GJATA GJATA	1049	1605	205/25	179	shtet
176	TIRANA 3	RUBIN	NURI	DIBRA	1127	3866	196/20	180	treteve
177	TIRANA 3	LEFTER FARIE	NEZIR SAIT	META META	4852, 194	2066	129/700	56	shtet
178	TIRANA 3	BESNIK	BEHEXHED	KAZIU	353	8551	1/550	500	pa inf
179	TIRANA 3	VIOLETA	MUHARREM	ZEMANI	95	3321	231/20	255	shtet
180	TIRANA 3	ALKETA	AGIM	MARTINI	94	3321	231/21	243	shtet
181	TIRANA 3	FATOS	DYLAVER	NDREU	1984	2066	73/201	366	treteve
182	TIRANA 3	YLBER	DYLAVER	NDREU	1985	2066	73/202	276	treteve
183	TIRANA 3	LAVDRIM	DYLAVER	NDREU	1986	2066	73/203	336	treteve
184	TIRANA 3	ASTRIT	RAMIZ	SULA	253	3127	40/48	441	pa inf
185	TIRANA 3	FATJON	DALIP	CUKA	13281	2460	505/372	399	shtet
186	TIRANA 3	ALI	IBRAHIM	KACI	1513/1	2460	203/10	500	shtet
187	TIRANA 3	ERTON MIRLIND	FADIL FADIL	DUKA DUKA	130	3865	98/150	159	shtet
Në të gjitha rastet, paraqitja e propozimit për miratim nga Këshilli i Ministrave, për hapjen e institucionit arsimor privat të arsimit parauniversitar, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, duhet të jetë përpara datës së fillimit të vitit mësimor.

4. Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të subjektit, Ministria e Arsimit dhe Sportit kërkon raport ekspertize, përkatësisht nga:

a) institucionet vartëse të specializuara për vlerësimin e kurrikulave;

b) përfaqësuesit e bashkësisë fetare dhe Komiteti Shtetëror për Kultet, kur institucioni arsimor privat do të zhvillojë edhe lëndë fetare.

Ministri i Arsimit dhe Sportit i propozon Këshillit të Ministrave projektvendimin për hapjen e institucionit arsimor privat përkatës, pasi të jenë përmbushur kriteret, sipas këtij vendimi.

#### IV. TARIFAT E SHËRBIMIT

1. Tarifat e kërkesave për hapje të institucioneve arsimore parauniversitare private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, janë sipas tabelës në vazhdim:

Nr.	Institucionet	Tarifa në lekë
1.	Për kopsht	35 000 (tridhjetë e pesë mijë)
2.	Për shkollë të arsimit fillor	45 000 (dyzet e pesë mijë)
3.	Shkollë të arsimit të mesëm, të ulët	45 000 (dyzet e pesë mijë)
4.	Shkollë të arsimit bazë	55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë)
5.	Shkollë të arsimit të mesëm, të lartë	70 000 (shtatëdhjetë mijë)

2. Tarifa e shërbimit paguhet për llogari të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Shuma e të ardhurave të realizuara nga tarifatat e shërbimit, sipas pikës IV, të këtij vendimi, derdhet 100% në buxhetin e shtetit.

3. Tarifatat e paguara për shërbimet, sa më lart, janë të pakthyeshme.

#### V. MBYLLJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, NË TË CILAT ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ

1. Subjekti, që e mbyll vetë institucionin arsimor privat, njofton me shkresë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për arsytet e mbylljes. Kur një subjekt nuk e përmbush këtë detyrim, ai nuk ka të drejtë të kërkojë hapjen e një institucioni arsimor privat, të çfarëdo lloji, për 5 vite shkollore pasuese.

2. Subjekti që nuk e hap institucionin arsimor privat gjatë dy viteve shkollore të njëpasnjëshme,

nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, e humbet të drejtën e hapjes së institucionit.

Subjekti duhet të përsëritë procedurat për rihapjen e institucionit arsimor privat.

3. Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe autoritetet tatimore njoftojnë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kur konstatojnë shkelje të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim nga institucionet arsimore private.

Ministri i Arsimit dhe Sportit, pas njoftimit nga këto organe publike:

a) njofton subjektin që të kryejë përmirësimet në dokumentacion ose ndreqjet në infrastrukturë, brenda një afati të caktuar;

b) paraqet propozimin në Këshillin e Ministrave për mbylljen e institucionit.

4. Subjekti, pas miratimit për hapjen e institucionit arsimor privat, ka detyrimin të njoftojë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me shkresë zyrtare, jo më vonë se tre muaj para fillimit të vitit shkollor, kur ndryshon:

a) vendndodhja e institucionit;

b) numri i klasave paralele (kur shtohet);

c) struktura e vitit shkollor, plani mësimor ose ndonjë program mësimor;

ç) aspekte të infrastrukturës, sipas shtojcës.

5. Subjekti, për ndryshimin/ndryshimet e parashikuara në pikën 4, të këtij kreu, paraqet dokumentacionin, sipas këtij vendimi, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashikuar më sipër, ministri i Arsimit dhe Sportit:

a) njofton subjektin që të kryejë përmirësimet në dokumentacion ose ndreqjet në infrastrukturë, sipas afateve të përcaktuara;

b) miraton ndryshimet e mësipërme;

c) paraqet propozimin në Këshillin e Ministrave për mbylljen e institucionit, në rast mosplotësimi të dokumentacionit ose të kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

6. Me mbylljen e institucionit arsimor privat, njësia arsimore vendore përkatëse tërheq të gjithë dokumentacionin arsimor të institucionit.

#### VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 248, datë 28.5.1999, i Këshillit të Ministrave, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve arsimore plotësuese



jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësitë bazë të qeverisjes vendore dhe njësitë arsimore vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**

SHTOJCË

### STANDARDET E INFRASTRUKTURËS SË OBJEKTIT SHKOLLOR

1. Klasa, si mjedis mësimor, të ketë një normativë sipërfaqeje shfrytëzimi prej 1.3-1.6 m<sup>2</sup>/nxënës.

2. Ndërtesa dhe mjediset e saj të plotësojnë kushtet për sigurimin e jetës dhe të shëndetit, të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

3. Të sigurohen, sipas legjislacionit në fuqi, shërbimet e mëposhtme:

- a) furnizimi me ujë;
- b) ngrohja;
- c) furnizimi me energji elektrike;
- ç) komunikim telefonik dhe interneti.

4. Numri i nxënësve, në çdo dhomë mësimore, të jetë jo më i madh se standardet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

5. Nyjat hidrosanitare të përfshijnë 1(një) boks për 40 djem, 1 (një) boks për 30 vajza si dhe 1 (një) boks për punonjësit arsimorë të institucionit.

6. Për kopshtet, shërbimet higjienike të jenë të vendosura pranë çdo grupi të nxënësve. Numri i bokseve të jetë 3, për një grup. Bokset të jenë të ndara me mure nga njëri-tjetri dhe të kenë nga 4 lavamanë me ujë të pijshëm. Banjat të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja.

7. Për lëndën e edukimit fizik të jetë në dispozicion një palestër sportive. Për shkollat nën 100 nxënës mund të shfrytëzohet një klasë, në katin përdhe të godinës, me përmasa 60 m<sup>2</sup>, dhe një kënd sportiv jo më i vogël se 100 m<sup>2</sup>.

8. Objektet arsimore, që vihen në dispozicion për nivele të ndryshme shkollimi (kopshte, arsim bazë dhe arsim i mesëm i lartë), të jenë mjedise që nuk komunikojnë me njëri-tjetrin.

9. Sipërfaqja e dritareve të mbulojë, minimalisht, 15% të sipërfaqes së dyshemesë, dhe ndriçimi të jetë në krahun e majtë të nxënësit, mundësisht i

orientuar nga juglindja. Ndriçimi të realizohet me dritare me xham të tejdukshëm. Dritaret nuk lejohet të vendosen në murin ku është vendosur tabela e zezë.

10. Në shkolla të jenë, të paktën, aq dhoma mësimore sa është numri i klasave. Në shkollat e arsimit bazë dhe gjimnaze të jenë 1-2 dhoma për mësuesit.

Për kopshtet të jenë të paktën 3 dhoma mësimore dhe një dhomë mësuesish.

11. Objektet arsimore me mbi 200 nxënës të pajisen me dalje dhe shkallë emergjence.

12. Objektet arsimore të jenë të pajisura me kutinë e ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e nevojshme në të.

13. Objektet arsimore të kenë sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.

14. Objektet arsimore të jenë të ndërtuara me materiale që plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe nuk janë të rrezikshme për shëndetin e nxënësve dhe punonjësve arsimorë.

Këto materiale të sigurojnë akustikë të mirë, në mjediset e mësimi, dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave të jashtme dhe luhatjeve të temperaturës.

15. Objektet arsimore të jenë larg zonave industriale, varrezave ose zonave me ndotje mbi normat e lejuara.

### VENDIM

**Nr. 826, datë 7.10.2015**

### **PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, KRITEREVE DHE AFATEVE PËR NDJEKJEN E PROGRAMEVE TË FORMIMIT E TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL PËR INDIVIDËT QË USHTROJNË PROFESIONIN E PUNONJËSIT SOCIAL PËR NJË PERIUDHË TË CAKTUAR KOHE, POR NUK KANË FORMIMIN DHE KUALIFIKIMIN PROFESIONAL MINIMAL PËR PUNONJËS SOCIAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 19, të ligjit nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

1. Çdo person, i cili në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, ushtron ose ka ushtruar profesionin e punonjësit social dhe zotëron diplomën e studimeve të ciklit të parë ose të ciklit të dytë ose ekuivalentet me to të punonjësit social, përjashtohet nga detyrimi për dhënien e provimit të shtetit. Atij i lind e drejta e menjëhershme e anëtarësimit në Urdhrin e Punonjësve Socialë.

2. Çdo person, i cili, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, ushtron ose ka ushtruar profesionin e punonjësit social dhe ka përfunduar me sukses provimin e shtetit në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, Zvicër, Lihtenshtein, Norvegji, Islandë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Japoni ose vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për këtë qëllim, përjashtohet nga detyrimi për dhënien e provimit të shtetit. Atij i lind e drejta e anëtarësimit në Urdhrin e Punonjësve Socialë, me qëllim që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit.

3. Çdo person, i cili në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, ushtron ose ka ushtruar profesionin e punonjësit social për një periudhë të pandërprerë prej jo më pak se 10 vjetësh dhe zotëron diplomën e studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në një fushë tjetër, është i detyruar të ndjekë kursin e kualifikimit 1-vjeçar pranë Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale, të Fakultetit të Shkencave Sociale, në Universitetin e Tiranës. Ky kurs kualifikimi duhet të ndiqet brenda 2 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Çdo person, i cili përfundon kursin e sipërpërmendur të kualifikimit, përjashtohet nga detyrimi për dhënien e provimit të shtetit.

4. Profesionisti i përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, aplikon për regjistrim për ushtrim të profesionit të punonjësit social në Republikën e Shqipërisë pranë Urdhrit të Punonjësve Socialë. Pas shqyrtimit të aplikimit, kur plotësohen kriteret e pikave 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, Urdhri i

Punonjësve Socialë kryen regjistrimin e profesionistit.

5. Çdo person, i cili në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, ushtron ose ka ushtruar profesionin e punonjësit social për një periudhë të pandërprerë prej 5 vjetësh dhe zotëron diplomën e studimeve të ciklit të dytë të punonjësit social dhe diplomën e studimeve të ciklit të parë në një fushë tjetër, është i detyruar të japë provimin e shtetit, brenda 2 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Çdo person, i cili në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, ushtron ose ka ushtruar profesionin e punonjësit social për një periudhë të pandërprerë prej 5 vjetësh dhe zotëron diplomën e studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në një fushë tjetër, është i detyruar të ndjekë ciklin e dytë të studimeve në punë sociale, brenda 3 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Pas përfundimit të këtyre studimeve, ai jep provimin e shtetit.

7. Personat e përcaktuar në pikat 3, 5 dhe 6, të këtij vendimi, aplikojnë pranë Urdhrit të Punonjësve Socialë dhe regjistrohen në një regjister të posaçëm të tij deri në përfundim të periudhës së detyruar për kryerjen e kursit të kualifikimit profesional apo dhënien e provimit të shtetit.

8. Urdhri i Punonjësve Socialë, menjëherë pas përfundimit të periudhës së përcaktuar në pikat 3, 5 dhe 6, të këtij vendimi, pasi verifikon se individ nuk ka kryer kursin e kualifikimit profesional apo nuk ka dhënë provimin e shtetit, njofton institucionin publik ose privat, pranë të cilit është punësuar individ, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me individin.

9. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**



## VENDIM

Nr. 827, datë 7.10.2015

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 649, DATË 14.9.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SPECIALITETEVE, NËNSPECIALITETEVE APO SPECIALITETEVE PLOTËSUESE PËR PROFESIONET E RREGULLUARA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, në shtojcën 1 “Lista e specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, pas ndarjes X shtohet ndarja XI, me këtë përmbajtje:

“XI. Profesioni i punonjësit social (diplomë e ciklit të parë ose ekuivalente me të apo diplomë e ciklit të dytë ose ekuivalente me të).”.

2. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

## VENDIM

Nr. 828, datë 7.10.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË KRIJIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIT ELEKTRONIK PËR NJOFTIMET DHE KONSULTIMET PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Krijimin, funksionimin, administrimin dhe monitorimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) dhe publikimin e tij në formën e një portali elektronik, faqeje *web-i*, me adresë elektronike: <http://www.konsultimi publik.gov.al>.

2. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike drejton procesin e krijimit, funksionimit, administrimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

3. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike do të hostohet në serverat e Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI).

4. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike përfshin:

a) si të dhëna parësore, të gjitha njoftimet dhe projektaktet që publikohen për herë të parë në RENJK, siç përcaktohet në pikën 9, të këtij vendimi;

b) si të dhëna dytësore, të gjitha projektaktet që tërhiqen nga databaza e organit publik ku janë të publikuara për herë të parë sipas legjislationit të posaçëm/sectorial të funksionimit të organit publik.

5. Të gjitha organet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, janë dhënë të informacionit për Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

6. AKSHI, si autoritet rregullues e koordinator për bazat e të dhënave shtetërore, rast pas rasti, përcakton shkallën e ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave për publikimin e projektakteve.

7. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike ofron akses të hapur dhe pa pagesë për informim, printim dhe ripërdorim të dokumenteve të publikuara në të për të gjithë përdoruesit, grupet e interesit.

8. Të gjitha organet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, kanë akses në hedhjen dhe editimin e të dhënave respektive në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e informacionit të publikuar prej tyre.





9. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike përmban në bazën e tij të të dhënave:

a) të gjitha projektdokumentet strategjike, kombëtare dhe vendore, si dhe të politikave me interes të lartë publik;

b) të gjitha projektaktet, njoftimet për konsultim dhe të dhënat e lidhura me konsultimin e projektakteve;

c) planet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;

ç) informacionin në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

10. Të gjitha projektaktet në faqen *web* duhet të jenë të plota. Çdo projektakt duhet të publikohet si një dosje/*file* e veçantë në format elektronik të përshtatshëm, për t’u ruajtur, shkarkuar dhe ripërdorur sipas rregullores së miratuar nga AKSHI për të dhëna të hapura.

11. Çdo organ publik i ngarkuar për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duhet të caktojë një punonjës të administratës, përgjegjës për të grumbulluar, sistemuar, përshtatur dhe hedhur në formatin e duhur, në faqen e *web*-it, të gjitha projektaktet e iniciuara nga të gjitha strukturat dhe departamentet e institucionit përkatës, si edhe për të bërë përditësimin e vazhdueshëm të regjistrit. Kjo detyrë duhet të përfshihet në përshkrimin e punës së personit të caktuar.

12. Personi i caktuar nga çdo organ publik ka detyrimin për të pasqyruar të dhënat e kërkuara në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, jo më vonë se 48 orë nga momenti i miratimit të dokumentit nga organi publik, përveçse kur me urdhër të organit publik ose nisur nga natyra e informacionit, regjistrimi duhet të kryhet brenda një afati më të shkurtër.

13. Personi i caktuar nga çdo organ publik duhet të pajiset nga administratori i Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike me emrin e përdoruesit “*user name*” dhe fjalëkalimin “*password*”, si dhe me manualët për hedhjen e të dhënave në sistem, operimin, përdorimin e faqes *web* etj.

14. Çdo organ publik, që përfshihet në hedhjen e projektakteve në <http://www.konsultimipublik.gov.al>, është përgjegjës për tërësinë dhe llojshmërinë e akteve të hedhura, cilësinë, integritetin, formatin dhe renditjen hierarkike dhe lidhjen e akteve ndërmjet tyre, vendosjen sipas fushës së veprimtarisë, institucionit etj.

15. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është përgjegjës për hostimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe garanton funksionimin në mënyrë të vazhdueshme të tij, mbrojtjen nga viruset dhe sulmet e ndryshme të kësaj faqeje dhe informacionit që gjendet në të, kryerjen periodike të *back-up*-it etj. AKSHI, sipas nevojave, përgjigjet dhe për zhvillimin periodik të RENJK-së.

16. Deri në krijimin dhe bërjen funksional të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, konsultimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, bëhet përmes faqes zyrtare të çdo institucioni.

17. Ngarkohen ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike, të gjitha organet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

## VENDIM

Nr. 830, datë 7.10.2015

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE**





**TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË  
VARËSI TË KRYEMINISTRIT,  
INSTITUCIONET NË VARËSI TË  
MINISTRAVE TË LINJËS DHE  
ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË  
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në shkronjën “a”, të pikës 1/3, të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet emërtesa “Agjencia e Zhvillimit të Territorit”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë nga momenti i emërimit në detyrë të nëpunësve/punonjësve të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe, për vitin 2015, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë institucion për vitin 2015.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**

**VENDIM  
Nr. 831, datë 7.10.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN  
NR. 82, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN,  
PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE  
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,  
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA  
REALIZIMI I PROJEKTIT  
“RIKONSTRUKSION DHE ZGJERIM I  
RRUGËS “DON GJON BUZUKU”,  
KORÇË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të aktit normativ, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 82, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Në pikat 3 dhe 4, vlera 88 587 210 (tetëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dhjetë) lekë bëhet 76 380 873 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

2. Tabela, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**



TABELA E DETAJUAR E VLERËS SË SHPRONËSIMIT PËR PROJEKTIN "RIKONSTRUKSION DHE ZGJERIM I RRUGËS 'DON GJON BUZUKU',  
KORÇË

Nr.	Nr. pasurie	Emër, atësi, mbiemër	Lloji i pasurisë	Sip. truall total sipas ZVRPP m <sup>2</sup>	Vlera truall lekë/m <sup>2</sup>	Nr. kate	Sip. banesë totale nd. (m <sup>2</sup> )	Vlera banesa lekë/m <sup>2</sup>	Sip. njësi shërbim (m <sup>2</sup> )	SIP. truallit e pjesshme (m <sup>2</sup> )	Vlera e truallit total (lekë)	Vlera e banesës (lekë)	Vlera e njësisë shërbim (lekë)	Sip. truallit nën ndërtesë (m <sup>2</sup> )	Sip. truallit jashtë ndërtesës (m <sup>2</sup> )	Vlera e truallit jashtë ndërtesës (lekë)	Totali shpronësim (lekë)
1	5/347	Rita Ali Koça, Spiro Hekuran Koça	T+Nd	79.6	7,535	2.5	137	45,230				6,196,510		54.8	24.8	186,868	6,383,378
2	5/598	<b>Natasha Alit Strati(Zesllati)</b>	<b>T+Nd</b>	<b>99</b>	<b>7,535</b>	<b>2</b>	<b>29.6</b>	<b>45,230</b>				<b>1,338,808</b>		<b>58.8</b>	<b>40.2</b>	<b>302,907</b>	<b>1,641,715</b>
3	5/876	Agim Beshir Bardhi + bpr	T+Nd	70.5	7,535	1	38.5	45,230				1,741,355		38.5	32.0	241,120	1,982,475
4	5/824	Bajram Faslli Tako	Nd		7,535	1	45	45,230				2,035,350		45.0	0.0	0	2,035,350
5	5/130	Arben Feta	T+Nd	131	7,535	2	171	45,230				7,734,330		85.5	45.5	342,843	8,077,173
6	5/558	Jorgo Stefá	T+Nd	114	7,535	1	78.08	45,230				3,531,558		78.1	35.9	270,657	3,802,216
7	5/859	Agim Hajdar Tefik	T+Nd	114	7,535	3	152.22	45,230				6,884,911		50.7	63.3	476,664	7,361,575
8	5/177	<b>Hydri Sabri Kape</b>	<b>T+Nd</b>	<b>135.3</b>	<b>7,535</b>	<b>2</b>	<b>45.6</b>	<b>45,230</b>				<b>2,062,488</b>		<b>91.6</b>	<b>43.7</b>	<b>329,280</b>	<b>2,391,768</b>
9	5/175	Gurije Rakollari +bpr	T+Nd	134.4	7,535	1	31.9	45,230				1,442,837		31.9	102.5	772,338	2,215,175
10	5/426	Petrit Musa Xhelollari	T+Nd	137.8	7,535	3	247	45,230	74		1,038,323	11,171,810	2,154,342	108.0	29.8	224,543	14,364,475
11	5/440	<b>Zamir Islam Topi</b>	<b>T+nd</b>	<b>22.8</b>	<b>7,535</b>						<b>171,798</b>	<b>0</b>		<b>59.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0</b>	<b>996,857</b>
12	5/458	Robert Çarçani	T+Nd	90	7,535	1			70		678,150	0	2,145,487	70.0	20.0	150,700	2,823,637
13	5/352	<b>Serdil Manka ,Musa Manka</b>	<b>T+Nd</b>	<b>170.7</b>	<b>7,535</b>	<b>2</b>	<b>142.4</b>	<b>45,230</b>		<b>49.2</b>		<b>6,440,752</b>		<b>59.5</b>		<b>370,722</b>	<b>6,811,474</b>
14	5/131	<b>Ari Fuat Maliq</b>	<b>T+Nd</b>	<b>135.2</b>	<b>7,535</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>45,230</b>		<b>58</b>	<b>437,030</b>	<b>316,610</b>		<b>0.0</b>	<b>58.0</b>	<b>437,030</b>	<b>753,640</b>
15	5/348	<b>Zini Besim Berberi</b>	<b>T</b>	<b>441.4</b>	<b>7,535</b>					<b>90.7</b>	<b>683,425</b>				<b>441.4</b>	<b>683,425</b>	<b>683,425</b>
16	5/353	<b>Ali Afiz Goçllari</b>	<b>T</b>	<b>184.2</b>	<b>7,535</b>					<b>27.4</b>	<b>206,459</b>			<b>0.0</b>	<b>184.2</b>	<b>206,459</b>	<b>206,459</b>
17	5/556	<b>Gjylizar Koçibelli</b>	<b>T</b>	<b>120.8</b>	<b>7,535</b>					<b>5.2</b>	<b>39,182</b>			<b>0.0</b>	<b>120.8</b>	<b>39,182</b>	<b>39,182</b>
18	5/829	Kristal Shyti	T	66.2	7,535						498,817					498,817	498,817
19	5/537	Salie Shishmani	T	151.2	7,535						1,139,292					1,139,292	1,139,292
20	5/538	Hektor Frashëri	T	66.6	7,535						501,831					501,831	501,831
21	5/441	Altin Ismail Topi+bpr	T	118.1	7,535						889,884					889,884	889,884
22	5/452	Edmond Haxhi Zake	T	202	7,535						1,522,070					1,522,070	1,522,070
23	5/439	Mukadez Riza Topi	T	177	7,535						1,333,695					1,333,695	1,333,695
24	5/472	Feride Teki Moskopoli	T	77.3	7,535						582,456					582,456	582,456
25	5/475	Isa Tefik Gegollari	T	78	7,535						587,730					587,730	587,730
26	5/448	Ali Qeraxhi + bpr	T	750	7,535						5,651,250			750.00		5,651,250	5,651,250
27	5/900	Riza Zeni Lika + bpr	T	69.5	7,535						523,683					523,683	523,683
28	5/964	Vladimir Agolli + bpr	T	77	7,535						580,195					580,195	580,195
<b>TOTALI</b>																	<b>76,380,873</b>



## UDHËZIM

Nr. 8, datë 15.9.2015

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 3.6.2010  
“KUADRI RREGULLATIV NË QIELLIN E  
VETËM EVROPIAN”, NË UDHËZIMIN  
NR. 6, DATË 3.6.2010 “MBI DISPOZITAT E  
SHËRBIMIT TË NAVIGIMIT AJROR NË  
QIELLIN E VETËM EVROPIAN”, NË  
UDHËZIMIN NR. 7, DATË 3.6.2010 “MBI  
ORGANIZIMIN DHE PËRDORIMIN E  
HAPËSIRËS AJRORE BRENDA QIELLIT  
TË VETËM EVROPIAN” DHE NË  
UDHËZIMIN NR. 8, DATË 3.6.2010 “PËR  
NDËRVEPRIMIN NË RRJETIN  
EVROPIAN TË MENAXHIMIT TË  
TRAFIKUT AJROR”, ME QËLLIM  
PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS  
DHE QËNDRUESHMËRISË SË  
SISTEMIT TË AVIACIONIT CIVIL<sup>1</sup>**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 78, nenit 79 dhe nenit 81 të ligjit 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

## UDHËZON:

1. Në udhëzimin e ministrit nr. 5, datë 3.6.2010 “Mbi krijimin e strukturës së qiellit të vetëm evropian (kuadri rregullator)”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.1 Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

**Objekti dhe qëllimi**

Objekti i nismës së qiellit të vetëm evropian është përmirësimi i standardeve aktuale të sigurisë së trafikut ajror, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit të transportit ajror dhe për të përmirësuar performancën e përgjithshme të

<sup>1</sup> Ky udhëzim përaftron rregulloren nr. 1070/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 21 tetor 2009, që amendon rregulloret (EC) nr. 549/2004, (EC) nr. 550/2004, (EC) nr. 551/2004 dhe (EC) nr. 552/2004 me qëllim përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmërisë së sistemit të aviacionit evropian.

menaxhimit të trafikut ajror (MTA) dhe shërbimeve të lundrimit ajror (SHLA) për trafikun ajror në përgjithësi në Evropë, me qëllim plotësimin e kërkesave të të gjithë përdoruesve të hapësirës ajrore.

Ky qiell unik evropian do të përbëhet nga një rrjet koherent mbarevropian rrugësh, sistemesh të menaxhimit të rrjetit dhe të trafikut ajror, bazuar vetëm në sigurinë, efikasitetin dhe vlerësimet teknike, në favor të të gjithë përdoruesve të hapësirës ajrore. Në arritjen e këtij objekti, ky udhëzim përcakton një kuadër rregullator të harmonizuar me atë evropian, në funksion të krijimit të një qielli të vetëm evropian.

Zbatimi i këtij udhëzimi dhe i masave të përmendura në nenin 3 do të kryhet pa cenuar sovranitetin kombëtar mbi hapësirën përkatëse ajrore dhe rregullat kombëtare në lidhje me rendin publik, sigurinë publike dhe çështjet e mbrojtjes. Ky udhëzim dhe masat e përmendura në nenin 3, nuk mbulojnë operimet dhe trajnimet ushtarake.

Zbatimi i këtij udhëzimi dhe i masave të përmendura në nenin 3 do të kryhet pa cenuar të drejtat dhe detyrimet kombëtare sipas Konventës së Çikagos mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar të vitit 1944. Në këtë kontekst, një tjetër objektiv shtesë i këtij udhëzimi është, që në fushat që ai mbulon, të asistojë Autoritetin e Aviacionit Civil, në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Konventës së Çikagos, duke ofruar një bazë për interpretim të përbashkët dhe zbatim uniform të parashikimeve të saj, dhe duke siguruar që këto parashikime të merren parasysh sa duhet në këtë udhëzim dhe në rregullat e hartuara për zbatimin e tij.”

1.2 Neni 2 shfuqizohet.

1.3 Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

**Autoriteti kombëtar mbikëqyrës**

1. Autoriteti i Aviacionit Civil është autoriteti kombëtar mbikëqyrës, i cili do të marrë përsipër detyrat që i janë caktuar një autoriteti të tillë sipas këtij udhëzimi dhe në bazë të masave të përmendura në nenin 3.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil është i pavarur nga ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror. Kjo pavarësi është arritur nëpërmjet ndarjes adekuate, të paktën në nivelin funksional, midis autoritetit kombëtar të mbikëqyrjes dhe ofruesit.



3. Autoriteti kombëtar i mbikëqyrjes ushtron kompetencat e tij në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe transparente. Kjo arrihet nëpërmjet zbatimit të mekanizmave të duhur të menaxhimit dhe të kontrollit, përfshirë brenda administratës tij. Megjithatë, kjo nuk e pengon Autoritetin e Aviacionit Civil që të ushtrojë detyrat e tyre në kuadër të rregullave të brendshme të saj.

4. Buxheti i AAC-së duhet të sigurojë që autoriteti kombëtar i mbikëqyrjes të ketë aftësitë për të realizuar detyrat që i janë caktuar atyre sipas këtij udhëzimi në mënyrë efektive dhe në kohë.

5. AAC njofton Komitetin e Përbashkët siç përcaktohet në Marrëveshjen Shumëpalëshe, për emrin dhe adresën e autoritetit, si dhe ndryshimet në to, si dhe për masat e marra për të siguruar pajtueshmërinë me pikat 2, 3 dhe 4.”.

1.4 Neni 5 shfuqizohet.

1.5 Pas nenit 5 shtohet neni 5a, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 5a

#### **Marrëdhënia me vendet e tjera evropiane**

Komuniteti dhe shtetet e tij anëtare synojnë mbështetjen dhe zgjerimin e qiellit të vetëm evropian për vendet të cilat nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, edhe RSH-ja është pjesë e iniciativave, qoftë në kuadrin e marrëveshjeve të përfunduara me vendet e tjera fqinje apo në kontekstin e marrëveshjeve për blloqet funksionale të hapësirës ajrore, me qëllim zbatimin e masave të përmendura në nenin 3.”.

1.6 Neni 6, neni 7 dhe neni 8 ndryshohen si më poshtë:

“Neni 6

#### **Sanksionet**

Sanksionet që AAC-ja zbaton për shkeljet e parashikimeve të këtij udhëzimi dhe masave të përmendura në nenin 3, në veçanti nga ana e përdoruesve të hapësirës ajrore dhe ofruesve të shërbimeve ajrore, janë përcaktuar në Kodin Ajror të RSH-së dhe do të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse.

Neni 7

#### **Konsultimi i palëve të interesuara**

1. Autoriteti i Aviacionit Civil, duke vepruar në përputhje me legjislacionin kombëtar, do të vendosë dhe zbatojë mekanizmat e konsultimit për përfshirjen e duhur të palëve të interesuara,

përfshirë organet përfaqësuese të stafit profesional, në zbatimin e Qiellit të Vetëm Evropian.

2. Konsultimi i palëve të interesuara do të mbulojë, në veçanti, zhvillimin dhe futjen e koncepteve dhe teknologjive të reja në ATMN (Rrjeti i Menaxhimit të Trafikut Ajror).

Te palët e interesuara mund të përfshihen:

- Ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror;
- Operatorët e aeroportit;
- Përdoruesit përkatës të hapësirës ajrore apo grupet që përfaqësojnë përdoruesit e hapësirës ajrore;
- Autoritetet ushtarake;
- Industria e prodhimit; dhe
- Organet përfaqësuese të stafit profesional.

Neni 8

#### **Skema e performancës**

1. Për të përmirësuar performancën e shërbimeve të lundrimit ajror dhe funksionet e rrjetit në Qiellin e Vetëm Evropian, duhet të hartohet një skemë e performancës për shërbimet e lundrimit ajror dhe funksioneve të rrjetit. Ajo do të përfshijë:

a) përshatjen me objektivat e performancës në nivel kombëtar dhe rajonal kur RSH të jetë pjesë e FABs në fushat kryesore të performancës të sigurisë, mjedisit, kapacitetit dhe efikasitetit të kostove;

b) planet kombëtare ose planet për blloqet funksionale të hapësirës ajrore, përfshirë objektivat e performancës, duke siguruar pajtueshmëri me objektivat e performancës së Komunitetit; dhe

c) rishikimin, monitorimin dhe krahasimin periodik të performancës së shërbimeve të lundrimit ajror dhe funksioneve të rrjetit.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil në cilësinë e Autoritetit Mbikëqyrës Kombëtar do të koordinojë me Komisionin, dhe me organin e përcaktuar prej tij për rishikimin e performancës për të përfituar ndihmë për zbatimin e skemës së performancës të përmendura në pikën 1.

3.a) Planet kombëtare apo të bllokut funksional të hapësirës ajrore të përmendura në shkronjën “b” të pikës 1 hartohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil dhe miratohen ministri përgjegjës për transportin. Këto plane përfshijnë objektiva të detyrueshme kombëtare apo objektiva në nivel të blloqeve funksionale të hapësirës ajrore dhe një skemë të përshtatshme nxitëse të miratuar në nivel shtetëror.



Hartimi i planeve i nënshtrohet konsultimeve me ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror, përfaqësuesit e përdoruesve të hapësirës ajrore dhe kur është e përshtatshme, operatorët e aeroportit dhe koordinatorët e aeroportit.

b) përputhja e objektivave kombëtare ose të bllokut funksional të hapësirës ajrore me objektivat e performancës së Komunitetit vlerësohet nga Komisioni, sipas parashikimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe;

Kur Komisioni konstaton se objektivat e rishikuara të performancës dhe masat e duhura nuk janë adekuate, ai, në zbatim të Marrëveshjes së Punës me AAC-në, mund të propozojë që Autoriteti i Aviacionit Civil të marrë masa korigjuese.

c) Periudha e referencës për skemën e performancës do të mbulojë një minimum prej tre vjetësh dhe një maksimum prej pesë vjetësh.

d) Komisioni kryen vlerësime rregullisht për arritjen e objektivave të performancës dhe i paraqet rezultatet tek Komiteti i Qiellit të Vetëm Evropian

4. Procedurat e mëposhtme zbatohen për skemën e performancës të përmendur në pikën 1:

a) mbledhja, përcaktimi i vlefshmërisë, ekzaminimi, vlerësimi dhe shpërndarja e të dhënave relevante që lidhen me kryerjen e shërbimeve të navigimit ajror dhe funksionet e rrjetit nga të gjitha palët relevante, duke përfshirë ofruesit e shërbimit të navigimit ajror, përdoruesit e hapësirës ajrore, operatorët e aeroportit, autoritetit kombëtar të mbikëqyrjes;

b) përzgjedhja e fushave kyç të përshtatshme të performancës në përputhje me ato të identifikuar në Kuadrin e Performancës së Master Planit të MTA përfshirë fushat e sigurisë, mjedisit, kapacitetit dhe efikasitetin e kostos, të përshtatura kur është e nevojshme me nevojat e veçanta të qiellit të vetëm evropian dhe objektivat përkatëse për këto zona dhe përcaktimin e një grupi indikatorëve kyç të performancës për matjen e performancës;

c) përcaktimin e objektivave të performancës duke marrë në konsideratë imputet e identifikuar në nivel kombëtar ose në nivel të blloqeve funksionale të hapësirës ajrore;

d) vlerësimin e objektivave të performancës kombëtare ose të bllokut funksional të hapësirës ajrore mbi bazën e planit kombëtar apo të bllokut funksionale të hapësirës ajrore; dhe

e) monitorimin e planeve të performancës kombëtare ose të bllokut funksional të hapësirës ajrore, përfshirë mekanizmat e përshtatshëm të paralajmërimit.

5. Krijimi i skemës së performancës merr parasysh faktin se shërbimet në udhëtim, shërbimet e terminalit dhe funksionet e rrjetit janë të ndryshme dhe duhet të trajtohet në përputhje me rrethanat, nëse është e nevojshme edhe për efekt të matjes së performancës.

6. Për funksionimin e hollësishëm të skemës së performancës, Autoriteti i Aviacionit Civil merr masa për projektimin e rregullave zbatuese. Këto rregulla zbatuese do të mbulojë aspektet e mëposhtme:

a) përmbajtjen dhe planin kohor të procedurave kombëtare;

b) periudhën e referencës dhe intervalet për vlerësimin e arritjes së objektivave të performancës dhe përcaktimin e objektivave të reja;

c) kriteret për krijimin e autoriteteve kombëtare të mbikëqyrjes dhe të planit të performancës kombëtare apo të bllokut funksional të hapësirës ajrore, që përmban objektivat e performancës dhe skemën e nxitjes kombëtare apo të bllokut funksional të hapësirës ajrore.

Planet e performancës:

i) bazohen në planet e biznesit të ofruesve të shërbimeve të navigimit ajror;

ii) adresojnë të gjithë komponentët e bazës së kostos kombëtare apo të bllokut funksional të hapësirës ajrore;

iii) përfshijë objektivat e detyrueshme të performancës në përputhje me objektivat e performancës së planit kombëtar apo të Komunitetit;

d) kriteret për të vlerësuar nëse objektivat kombëtarë apo të bllokut funksional të hapësirës ajrore janë në përputhje me objektivat e performancës së Komunitetit dhe për të mbështetur mekanizmat e paralajmërimit;

e) parimet e përgjithshme për krijimin e skemës së nxitjes;

f) parimet për zbatimin e një mekanizmi tranzitor të nevojshëm për përshtatjen e funksionimit të skemës së performancës që nuk tejkalon periudhën 12-mujore pas miratimit të rregullave zbatuese.”

1.7 Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1.7.1 Pika 2 ndryshohet si më poshtë:



“2. AAC-ja mbikëqyr periodikisht zbatimin e këtij udhëzimi. Kur justifikohet për këtë qëllim, Komisioni mund t'i kërkojë AAC-ja informacion shtesë përveç informacionit të ndodhur në raportet e paraqitura nga ato në përputhje me pikën 1 të këtij neni.”

1.7.2 Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Raportet do të përmbajnë një vlerësim të rezultateve të arritura nga veprimet e ndërmarra në bazë të këtij udhëzimi përfshirë informacion të përshtatshëm rreth zhvillimeve në sektor, në veçanti lidhur me aspektet ekonomike, sociale, mjedisore, të punësimit dhe teknologjike, si dhe për cilësinë e shërbimit, nën dritën e objektivave fillestare dhe me këndvështrimin e nevojave në të ardhmen.”

1.8 Pas nenit 10, shtohet neni 10a me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 10a

**Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit  
(EASA)**

Gjatë zbatimit të këtij udhëzimi dhe udhëzimeve të Ministrit nr. 6, nr. 7 dhe nr. 8, datë 3.6.2010, Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me rolin e tij përkatës, siç parashikohet nga ky udhëzim, koordinohen sipas rastit me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit për të siguruar që të gjitha aspektet e sigurisë janë adresuar siç duhet.

1.9 Në shtojcën I, bëhen këto ndryshime:

1.9.1 Pika 20 ndryshohet si më poshtë:

“20. “Përdorues të hapësirës ajrore” janë operatorët e mjeteve të fluturimit të operuar për trafik i përgjithshëm;”

1.9.2 Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. “Menaxhimi i trafikut ajror (MTA)” do të thotë agregimi i funksioneve ajrore dhe tokësore (shërbimet e trafikut ajror, menaxhimi i hapësirës ajrore dhe menaxhimi i fluksit të trafikut ajror), i kërkuar për të siguruar lëvizjen e sigurt dhe të efektshme të mjetit fluturues gjatë të gjitha fazave të operimit.”

1.9.3 Pas pikës 21, shtohet pika 21.a si më poshtë:

“21a. “Master Plani i MTA” do të thotë plani i mbështetur në vendimin e Këshillit Evropian rregullat evropiane mbi përcaktimin e një sipërmarrjeje të përbashkët për të zhvilluar gjeneratën e re të sistemit të menaxhimit të trafikut

ajror për krijimin e një sipërmarrjeje të përbashkët për të zhvilluar një gjeneratë të re të sistemit evropian të menaxhimit të trafikut ajror (SESAR);”

1.9.4 Pika 23 ndryshohet si më poshtë:

“23 “Certifikatë” nënkupton një dokument të lëshuar nga autoriteti kombëtar mbikëqyrës në çdo formë që përputhet me rregullat kombëtare, e cila konfirmon se një ofrues i shërbimit të lundrimit ajror i plotëson kërkesat për ofrimin e një shërbimi specifik;”

1.9.5 Pika 27 ndryshohet si më poshtë:

“27. “Përdorim fleksibël i hapësirës ajrore” do të thotë një koncept i menaxhimit të hapësirës ajrore i zbatuar në hapësirën e RSH-së, dhe atë të ZPEA, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, mbi bazën e “Manualit të menaxhimit të hapësirës ajrore për zbatimin e konceptit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore” të nxjerrë nga Eurokontroll;”

1.9.6 Pas pikës 28, shtohen pikat 28a dhe 28b si më poshtë:

“28a. “Shërbimi i informacionit aeronautik” do të thotë një shërbim i ofruar me qëllim dhënien e këshillave dhe informacioneve të dobishme për zhvillimin e sigurt dhe efikas të fluturimeve;

28b. “Shërbimi i paralajmërimit” do të thotë një shërbim i ofruar për të njoftuar organizatat përkatëse apo operatorët ajrorë lidhur me një mjet fluturimi në nevojë për ndihmë kërkimi dhe shpëtimi, dhe për të ndihmuar këto organizata sipas nevojës;”

1.9.7 Pika 30 ndryshohet si më poshtë:

“30. “Blloku funksional ajror” do të thotë një bllok i hapësirës ajrore i bazuar në kërkesat operacionale dhe i përcaktuar pavarësisht kufijve shtetërorë, ku ofrimi i shërbimeve të lundrimit ajror dhe funksionet e lidhura me to orientohen dhe optimizohen nga performanca, me synimin për të prezantuar në secilin bllok funksional të hapësirës ajrore, një bashkëpunim sa më të madh ndërmjet ofruesve të shërbimeve të lundrimit ajror ose, kur është e përshtatshme, një ofruesi të integruar;”

1.9.8 Pika 39 shfuqizohet.

1.9.9 Pas pikës 42, shtohet pika 43 me përmbajtje si më poshtë:

“43 “Shërbime ndërkuftare” do të thotë çdo rrethanë ku shërbimet e lundrimit ajror ofrohen në një Shtet Anëtar nga një ofrues shërbimi i certifikuar në një tjetër Shtet Anëtar, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe;”



2. Në udhëzimin e ministrit nr. 6, datë 3.6.2010 “Mbi dispozitat e Shërbimit të Navigimit Ajror në Qiellin e Vetëm Evropian” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

2.1 Nenet 2 deri në 4 ndryshohen me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 2

#### **Detyrat e autoritetit kombëtar mbikëqyrës**

1. Autoriteti kombëtar mbikëqyrës siguron mbikëqyrjen e duhur të zbatimit të këtij udhëzimi, në veçanti në lidhje me funksionimin e sigurt dhe efikas të ofruesve të shërbimeve të lundrimit ajror që ofrojnë shërbime që kanë lidhje me hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e Republikës së Shqipërisë.

2. Për këtë qëllim, Autoriteti i Aviacionit Civil organizon inspektimet dhe vëzhgimet e duhura për të verifikuar zbatimin e kërkesave të këtij udhëzimi, përfshirë kërkesat e kryerjes së punës nga burimet njerëzore të ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror. Ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror në fjalë do të lehtësojë dhe mbështeti këtë funksion.

3. Në lidhje me blloqet funksionale të hapësirës ajrore që shtrihen në hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e më shume se një shteti, Republika e Shqipërisë realizon marrëveshje lidhur me mbikëqyrjen e parashikuar në këtë nen, sa i takon ofruesve të shërbimeve të lundrimit ajror që ofrojnë shërbime në këto blloqe.

4. Autoriteti kombëtar mbikëqyrës i RSH-së do të bashkëpunojë ngushtësisht për të siguruar mbikëqyrjen adekuate të ofruesve të shërbimeve të lundrimit ajror që kanë një certifikatë të vlefshme nga një Shtet Anëtar që ofrojnë shërbime gjithashtu në lidhje me hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e RSH-së. Një bashkëpunim i tillë përfshin parashikimet për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë mosrespektimin e kërkesave të përbashkëta të zbatueshme të përcaktuara në nenin 6 ose me kushtet e përcaktuara në shtojcën II.

5. Në rastin e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror në nivel ndërkuftar, këto rregulla përfshijnë një marrëveshje mbi njohjen reciproke të detyrave mbikëqyrëse të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, si dhe të rezultateve të këtyre detyrave. Kjo njohje reciproke zbatohet gjithashtu edhe në rastet kur rregullat për njohje ndërmjet autoriteteve kombëtare mbikëqyrëse janë parashikuar për procesin e certifikimit të ofruesve të shërbimeve.

6. Me qëllim bashkëpunimin rajonal, autoritetet

kombëtare mbikëqyrëse mundën gjithashtu të lidhin marrëveshje për ndarjen e përgjegjësisë sa i përket detyrave mbikëqyrëse.

Neni 3

#### **Subjektet e kualifikuara**

1. Nëse lejohet nga legjislacioni vendas dhe në zbatim të marrëveshjeve shumëpalëshe të ratifikuara, Autoriteti i Aviacionit Civil, në cilësinë e autoritetit kombëtar mbikëqyrës, mund të vendosë që të delegojë plotësisht ose pjesërisht autoritetin për inspektimet apo vëzhgimet e përmendur në nenin 2 (2), te subjekte të kualifikuara që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shtojcën I.

2. Një delegim i tillë i kryer nga një autoritet kombëtar i mbikëqyrjes është i vlefshëm brenda ZPEA-së, sipas parashikimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, për një periudhë rinovuese prej tre vjetësh. Autoriteti i Aviacionit Civil, në cilësinë e autoritetit kombëtar mbikëqyrës, mund të udhëzojë secilin prej subjekteve të kualifikuara që ndodhen në territorin e ZPEA-së për kryerjen e këtyre inspektimeve dhe vëzhgimeve.

Neni 4

#### **Kërkesat e parrezikshmërisë**

Autoriteti i Aviacionit Civil merr masa për projektimin e përditësimeve të rregullave zbatuese që bien brenda fushës së veprimit të kësaj rregulloreje, me përshtatjet e duhura kur është e nevojshme.”.

2. 2 Neni 5 shfuqizohet.

2. 3 Në nenin 7, paragrafët 6 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:

“6. Pa cenuar nenet 8 dhe 9, lëshimi i certifikatave u jep ofruesve të shërbimeve të lundrimit ajror mundësinë për të ofruar shërbimet e tyre në RSH, apo ZPEA duke konsideruar edhe parashikimet e Marrëveshjes Shumëpalëshe, ofruesve të tjerë të shërbimit të lundrimit ajror, përdoruesve të hapësirës ajrore dhe aeroportëve brenda ZPEA-se, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe.

7. Autoriteti i Aviacionit Civil do të monitorojë respektimin e kërkesave të përbashkëta dhe të kushteve që i janë bashkangjitur certifikatave. Detajet për këtë monitorim përfshihen në raportet vjetore që duhet të paraqiten nga AAC-ja. Nëse Autoriteti i Aviacionit Civil konstaton se mbajtësi i një certifikate nuk i plotëson më këto kërkesa ose



kushte, ai merr masat e duhura, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve me kusht që siguria të mos komprometohet. Këto masa mund të përfshijnë edhe revokimin e certifikatës.”.

2.4 Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

#### **Përcaktimi i ofruesve të shërbimit të trafikut ajror**

1. Autoriteti i Aviacionit Civil siguron ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror mbi baza ekskluzive brenda blloqeve specifike të hapësirës ajrore, në lidhje me hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e tyre. Për këtë qëllim, Autoriteti i Aviacionit Civil përcakton një ofrues të shërbimit të trafikut ajror që ka një certifikatë të vlefshme të njohur dhe vlerësuar edhe nga EASA-ja.

2. Për ofrimin e shërbimeve ndërkuftare, garantohet që zbatimi i këtij neni dhe nenit 10 (3) të mos pengohet nga sistemi kombëtar ligjor që kërkon që ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror që ofrojnë shërbime në hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e RSH-së:

a) të jetë në pronësi të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një shumice të zotërohen nga RSH-ja apo një shtetas i saj;

b) të kenë vendin e tyre kryesor të operimit apo selinë e regjistruar në territorin e RSH; ose

c) të përdorin facilitete vetëm në RSH.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve që duhet të përmbushen nga ofruesit e përcaktuar të shërbimeve të trafikut ajror.

Detyrimet mund të përfshijë kushtet për dhënie në kohë të informacionit përkatës duke mundësuar identifikimin e të gjitha lëvizjeve të mjeteve të fluturimit në hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e tyre.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil ka kompetenca të drejtpërdrejta në përzgjedhjen e një ofruesi të shërbimeve të trafikut ajror, me kusht që ky i fundit të plotësojë kërkesat dhe kushtet e parashikuara në nenet 6 dhe 7.

5. Sa i takon blloqeve funksionale të hapësirës ajrore të krijuara në përputhje me nenin 9a që shtrihen në hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e më shumë se një Shteti Anëtar, Shtetet Anëtare përkatëse përcaktojnë së bashku, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, një ose më shumë ofrues të shërbimit të trafikut ajror, të paktën një muaj

përpara zbatimit të bllokut të hapësirës ajrore.

6. Shtetet Anëtare informojnë Komisionin dhe Shtetet e tjera Anëtare menjëherë për çdo vendim brenda kuadrit të këtij neni sa i përket përcaktimit të ofruesve të shërbimeve të trafikut ajror brenda blloqeve specifike të hapësirës ajrore në lidhje me hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e tyre, ashtu si Autoriteti i Aviacionit Civil informon Komitetin e përbashkët të Marrëveshjes Shumëpalëshe.”.

2.5 Pas nenit 9, shtohen nenet 9a dhe 9b me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 9a

#### **Blloqet funksionale të hapësirës ajrore**

1. Autoriteti i Aviacionit Civil, në zbatim të legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar të ratifikuar, do të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të sigurojë zbatimin e blloqeve funksionale të hapësirës ajrore me synimin arritjen e kapaciteteve të kërkuara dhe efikasitetin e rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror brenda qiellit të vetëm evropian dhe ruajtjen e një niveli të lartë të sigurisë dhe duke kontribuar në performancën e përgjithshme të sistemit të transportit ajror dhe në një ndikim mjedisor të reduktuar. AAC bashkëpunon në shkallën maksimale me shtetet anëtare të BE, në veçanti me Shtetet Anëtare me të cilat krijon blloqe funksionale të hapësirës ajrore fqinje, në mënyrë që të sigurohet respektimi i këtij parashikimi. Kur është rasti, bashkëpunimi mund të përfshijë edhe vendet e tjera (jo anëtare të BE-së) që marrin pjesë në blloqet funksionale të hapësirës ajrore.

2. Blloqet funksionale të hapësirës ajrore, në veçanti:

a) mbështeten nga një kasus mbi parrezikshmërinë;

b) mundësojnë përdorimin optimal të hapësirës ajrore, duke marrë në konsideratë flukset e trafikut ajror;

c) garantojnë pajtueshmëri me rrjetin evropian të rrugëve të krijuar në përputhje me nenin 6 të udhëzimit për hapësirën ajrore;

d) justifikohen nga vlera e tyre e përgjithshme e shtuar, përfshirë përdorimin optimal të burimeve teknike dhe njerëzore, mbi bazën e analizës së kostove dhe përfitimeve;

e) sigurojnë një kalim të qetë dhe fleksibël të përgjegjësisë për kontrollin e trafikut ajror ndërmjet njësisë të shërbimit të trafikut ajror;





f) sigurojnë pajtueshmërinë ndërmjet konfigurimeve të ndryshme të hapësirës ajrore, duke optimizuar, ndër të tjera rajonet aktuale të informimit të fluturimeve;

g) respektojnë kushtet që rrjedhin nga marrëveshjet rajonale të lidhura brenda ICAO;

h) respektojnë marrëveshjet rajonale ekzistuese në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, në veçanti ato që përfshijnë vendet e tjera evropiane; dhe

i) lehtësojnë pajtueshmërinë me objektivat e performancës së Komunitetit.

3. Një bllok funksional i hapësirës ajrore krijohet vetëm me marrëveshje të përbashkët me Shtetet Anëtare dhe, sipas rastit, shteteve të tjera që kanë përgjegjësi për ndonjë pjesë të hapësirës ajrore që është pjesë e bllokut funksional të hapësirës ajrore. Përpara se të njoftojnë Komisionin për krijimin e një blloku funksional të hapësirës ajrore, Shteti(et) Anëtar(e) në fjalë do t'i japin Komisionit, shteteve të tjera anëtare dhe palëve të tjera të interesuara informacion të mjaftueshëm si dhe mundësi për të paraqitur vërejtjet e tyre.

4. Kur një bllok funksional i hapësirës ajrore ka lidhje me një hapësirë ajrore që është tërësisht ose pjesërisht nën përgjegjësinë e dy apo më shumë shteteve, marrëveshja me të cilën krijohet blloku funksionale ajror duhet të përmbajë dispozitat e nevojshme në lidhje me mënyrën në të cilën do të mund të ndryshohet blloku si dhe mënyrën se si një shtet mund të tërhiqet nga blloku, përfshirë rregullat transitorë.

5. Ku lindin vështirësi midis dy ose më shumë shteteve në lidhje me një bllok ndërkufitar funksional të hapësirës ajrore që ka të bëjë me hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e tyre, Shtetet Anëtare të interesuara mundën që bashkërisht ta paraqesin çështjen për shqyrtim tek Komiteti i Qiellit të Vetëm Evropian për një opinion. Opinioni i drejtohet Shteteve Anëtare të interesuara. Pa cenuar pikën 3, Shtetet Anëtare e marrin parasysh këtë opinion për gjetjen e një zgjidhje.

6. Pasi të ketë marrë njoftimin nga Shtetet Anëtare për marrëveshjet dhe deklaratat e përmendura në pikat 3 dhe 4, Komisioni vlerëson përmbushjen nga çdo bllok funksional i hapësirës ajrore të kërkesave të përcaktuara në pikën 2 dhe i paraqet rezultatet tek Komiteti i Qiellit Unik për diskutim. Nëse Komisioni konstaton se një ose më

shumë blloqe funksionale të hapësirës ajrore nuk i përmbushin kërkesat, në këtë rast ai angazhohen në një dialog me Shtetet Anëtare të interesuara me qëllim arritjen e një konsensusi mbi masat e nevojshme për të ndrequr situatën.

Neni 9b

### **Koordinatori i bllokut funksional të hapësirës ajrore**

1. Për të lehtësuar krijimin e blloqeve funksionale të hapësirës ajrore, Komisioni mund të caktojë një person fizik si koordinator të sistemit të blloqeve funksionale të hapësirës ajrore (Koordinatorin).

2. Koordinatori nuk bën publik asnjë informacion që siguron gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai autorizohet për një gjë të tillë nga Shteti (et) Anëtar (e) dhe, kur është rasti, nga vendet e tjera të interesuara.”

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

### **Marrëdhëniet me autoritetet ushtarake**

Autoriteti i Aviacionit Civil, brenda kontekstit të politikës së transportit, ndërmerr hapat e nevojshëm për të siguruar që marrëveshje të shkruara me autoritetet ushtarake ose marrëveshje ekuivalente ligjore të lidhen apo rinovohen, sa i takon menaxhimin të blloqeve specifike të hapësirës ajrore.”

Në nenin 12, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Gjatë ofrimit të një pakete shërbimesh, ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror identifikojnë dhe japin informacion shpjegues për kostot dhe të ardhurat që rrjedhin nga shërbimet e lundrimit ajror, të ndara në përputhje me skemën e tarifave financiare për shërbimet e navigimit ajror përmendur në nenin 14 dhe, ku është e përshtatshme, mbajnë llogari të konsoliduara për shërbime të tjera, jo të shërbimit të lundrimit ajror, siç do t'u kërkohej të bënin, nëse shërbimet në fjalë do të siguroheshin nga ndërmarrje të veçanta.”

2.8 Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

### **E përgjithshme**

Në përputhje me kërkesat e neneve 15 dhe 16, skema e përcaktimit të tarifave financiare për shërbimet e lundrimit ajror do të kontribuojë për më shumë transparencë në përcaktimin, vendosjen



dhe zbatimin e tarifave financiare për përdoruesit e hapësirës ajrore dhe në efikasitetin e kostos në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror dhe efikasitetin e fluturime, duke ruajtur nivelin optimal të sigurisë. Kjo skemë do të jetë gjithashtu në përputhje me nenin 15 të Konventës së Çikagos mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar të vitit 1944 dhe me sistemin e tarifave financiare të Eurokontrollit për tarifatat në rrugë.”.

2.9 Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

### Parime

1. Skema e përcaktimit të tarifave bazohet në llogaritjen e kostove për shërbimet e lundrimit ajror të pësuar nga ofruesit e shërbimeve në favor të përdoruesve të hapësirës ajrore. Skema do alokojë këto kosto ndërmjet kategorive të përdoruesve.

2. Parimet e mëposhtme zbatohen gjatë përcaktimit të kostos-bazë për tarifatat:

a) kostoja që do të ndahet midis përdoruesve të hapësirës ajrore, është kostoja e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror, përfshirë shumat e përshtatshme të interesit për investimet kapitale dhe amortizimin e aseteve, si dhe kostot e mirëmbajtjes, operimit, menaxhimit dhe administrimit. Kostot e përcaktuara do të jenë kostot e përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil në nivel kombëtar ose në nivel të blloqeve funksionale të hapësirës ajrore ose në fillim të periudhës referuese për çdo vit kalendarik të periudhës së referencës sipas nenit 11 të Rregullores Kuadër, ose gjatë periudhës së referencës, pas përshtatjeve të duhura që zbatohen për mekanizmat e paralajmërimit të përcaktuara në nenin 11 të Rregullores Kuadër;

b) kostot që duhet të merren parasysh në këtë kontekst do të jenë ato të vlerësuara në raport me lehtësirat dhe shërbimet e parashikuara. Ato gjithashtu përfshijnë kostot e kryera nga autoriteti kombëtar mbikëqyrës dhe/ose subjektet e kualifikuara, si dhe kostot e tjera të realizuara nga shteti shqiptar dhe ofruesi i shërbimit në lidhje me ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror. Ato nuk përfshijnë kostot e sanksioneve të vendosura sipas legjislacionit në fuqi dhe në bazë të nenit 9 të Rregullores Kuadër dhe as kostot e masave korigjuese të imponuara nga shteti në përputhje me nenin 11 të Rregullores Kuadër.

c) sa i takon blloqeve funksionale të hapësirës ajrore dhe si pjesë e marrëveshjeve të tyre kuadër, shtetet palë bëjnë përpjekje të arsyeshme për të rënë dakord mbi parimet e përbashkëta për të politikatat e tarifimit;

ç) kostoja e shërbimeve të ndryshme të lundrimit ajror identifikohet veçmas, siç parashikohet në nenin 12 (3);

d) ndërsubvencionet nuk lejohen ndërmjet shërbimeve të rrugës (*en route*) dhe shërbimeve të terminalit. Kostot që i përkasin si shërbimeve të terminalit dhe atyre të rrugës do të alokohen në mënyrë proporcionale ndërmjet shërbimeve të rrugës dhe shërbimeve të terminalit mbi bazën e një metodologjie transparente. Subvencioni do të lejohet ndërmjet shërbimeve të ndryshme të lundrimit ajror në secilën prej këtyre dy kategorive vetëm kur kjo justifikohet për arsye objektive, që identifikohen në mënyrë të qartë;

e) transparenca e kostos bazë për tarifatat do të garantohet. Autoriteti i Aviacionit Civil do të hartojë rregullat zbatuese për dhënien e informacionit nga ofruesit e shërbimeve në mënyrë që të lejohet rishikimi i parashikimeve të ofruesve, shpenzimet dhe të ardhurat reale. Informacioni do të shkëmbehet rregullisht ndërmjet Autoritetit të Aviacionit Civil, ofruesve të shërbimeve, përdoruesve të hapësirës ajrore, Komisionit (sipas parashikimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe) dhe Eurokontrollit.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil garanton që do të zbatohen parimet e mëposhtme, gjatë përcaktimit të tarifave në përputhje me pikën 2:

a) tarifatat caktohen për disponueshmërinë e shërbimeve të lundrimit ajror në kushte jo-diskriminuese. Gjatë vendosjes së tarifave mbi përdorues të ndryshëm të hapësirës ajrore për përdorimin e të njëjtut shërbim, nuk do të bëhet asnjë dallim sa i takon shtetësisë apo kategorisë së përdoruesit;

b) përjashtimi i përdoruesve të caktuar, sidomos mjeteve të lehta të fluturimit dhe mjeteve të fluturimit të shtetit, mund të lejohet, me kusht që kostoja e një përjashtimi të tillë të mos i kalohet përdoruesve të tjerë;

c) tarifatat caktohen për çdo vit kalendarik mbi bazën e kostove të përcaktuara, ose mund të caktohen sipas kushteve të përcaktuara nga AAC-ja për përcaktimin e nivelit maksimal të normës për një njësi apo të të ardhurave për secilin



vit për një periudhë që nuk i kalon pesë vjet;

d) shërbimet e lundrimit ajror mund të krijojnë të ardhura të mjaftueshme për të siguruar një kthim të arsyeshëm mbi asetet (formë fitimi) për të kontribuar drejt përmirësimeve të nevojshme të kapitalit;

e) tarifat reflektojnë koston e shërbimeve të lundrimit ajror dhe faciliteteve të vëna në dispozicion të përdoruesve të hapësirës ajrore, duke marrë parasysh kapacitetet produktive përkatëse të mjeteve të llojeve të ndryshme të fluturimit në fjalë;

f) tarifat inkurajojnë ofrimin e sigurt, efikas, efektiv dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të lundrimit ajror me synimin për të arritur një nivel të lartë të sigurisë dhe efikasitetit të kostove dhe përmbushjen e objektivave të performancës ndërsa ato gjithashtu stimulojnë ofrimin e integruar të shërbimeve, duke reduktuar edhe ndikimin mjedisor të aviacionit. Për këtë qëllim, dhe në lidhje me planin e performancës kombëtare ose të bllokut funksional të hapësirës ajrore, autoritet kombëtare mbikëqyrëse mund të krijojnë mekanizma, përfshirë stimujt që konsistojnë në avantazhe dhe disavantazhe financiare, për të inkurajuar ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror dhe/ose përdoruesit e hapësirës ajrore që të mbështesin përmirësimet në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror të tilla si rritja e kapaciteteve, ulja e vonesave dhe zhvillimi i qëndrueshëm, duke ruajtur një nivel optimal të sigurisë.”.

2.10 Nenet 16 deri në 18 ndryshohen si më poshtë:

“Neni 16

### **Rishikimi i përputhshmërisë**

Komisioni merr masa për rishikimin e vazhdueshëm të respektimit të parimeve dhe rregullave të përmendura në nenet 14 dhe 15, duke vepruar në bashkëpunim me Shtetet Anëtare. Komisioni përpiqet që të krijojë mekanizmat e nevojshëm për të përdorur ekspertizën e Eurokontrollit dhe ndan rezultatet e rishikimit me Shtetet Anëtare, Eurokontrollin dhe përfaqësuesit e përdoruesve të hapësirës ajrore. Në përputhje me udhëzimet e KE dhe Eurokontroll, AAC në nivel kombëtar merr masa për rishikimin e vazhdueshëm të respektimit të parimeve dhe rregullave të përmendura në nenet 14 dhe 15.

Neni 17

### **Ndryshimi i shtojcave**

Masat e hartuara për të ndryshuar elemente jothelbësore të shtojcave për t’u përshtatur zhvillimeve teknike ose operacionale, do të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore të hollësishme të përmendur në nenin 5 (4) të Rregullores Kuadër.

Në rrethana detyruese urgjente, Komisioni mund të përdorë procedurën urgjente të parashikuar në nenin 5 (5) të Rregullores Kuadër.

AAC do të marrë masa për të hartuar në kohë propozimet për harmonizimin e shtojcave në fjalë.

Neni 18

### **Konfidencialiteti**

1. Autoriteti mbikëqyrës kombëtar, që vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar, nuk bën publik informacionin me natyrë konfidenciale, në veçanti informacionin në lidhje me ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror, marrëdhëniet e tyre të biznesit ose elementë të kostove të tyre.

2. Paragrafi 1 nuk cenon të drejtën e publikimit të informacionit që kanë autoritetet mbikëqyrëse kombëtare ose Komisioni, ku kjo është thelbësore për përmbushjen e detyrave të tyre, rast në të cilin ky publikim është proporcional dhe merr parasysh interesat legjitime të ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror, përdoruesve të hapësirës ajrore, aeroporteve apo palë të tjera të interesuara përkatëse për të mbrojtur sekretet e tyre të biznesit.

3. Informacioni dhe të dhënat e dhëna në bazë të skemës së tarifimit të përmendur në nenin 14 do të bëhen të ditura për publikun.”.

2.11 Shtojca I ndryshohet si më poshtë:

2.11.1 Titulli i shtojcës ndryshohet si më poshtë:  
“KËRKESAT PËR SUBJEKTET E KUALIFIKUARA”.

2.11.2 Paragrafi i parë ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Subjektet e kualifikuara duhet të:”.

3. Në udhëzimin e ministrit nr. 7 datë 3.6.2010 “Mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda Qiellit të Vetëm Evropian”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 2 shfuqizohet.

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 3

### Rajoni i Sipërm Evropian i Informacionit të Fluturimit (EUIR)

1. Komuniteti dhe Shtetet e tij Anëtare synojë krijimin dhe njohjen nga ana e ICAO të një EUIR të vetëm.

2. EUIR është projektuar në një mënyrë që të përfshijë hapësirën ajrore që bie nën përgjegjësinë e Shteteve Anëtare në përputhje me nenin 1 (3) dhe mund të përfshijë edhe hapësirën ajrore të vendeve të tjera evropiane.

3. Shqipëria mban përgjegjësinë e saj për përcaktimin e ofruesve të shërbimeve të trafikut ajror për hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e saj në përputhje me nenin 8 (1) të Rregullores së ofrimit të shërbimeve.

4. Shqipëria mban përgjegjësinë e saj kundrejt ICAO brenda kufijve gjeografikë të rajoneve të sipërme të informacionit të fluturimeve që i janë besuar atyre nga ICAO në datën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.”

3.3 Pas nenit 3 shtohet neni 3a si më poshtë:

“Neni 3a

#### Informacioni elektronik aeronautik

Pa cenuar botimin e informacionit aeronautik nga RSH dhe në një mënyrë në pajtim me këtë publikim, Komisioni, duke punuar në bashkëpunim me Eurokontrollin, siguron disponueshmërinë e informacionit elektronik aeronautik të cilësisë lartë, të paraqitur në një mënyrë të harmonizuar dhe që i shërben kërkesave të të gjithë përdoruesve përkatës sa takon cilësisë së të dhënave dhe të afateve kohore.

Për qëllim të pikës 1, Komisioni:

a) ka siguruar zhvillimin e një infrastrukture informative aeronautike për të gjithë Komunitetin në formën e një portali elektronik informues të integruar me mundësi të pakufizuar aksesit për palët e interesuara. Kjo infrastrukturë do të integrojë aksesin dhe ofrimin e elementeve të të dhënave të kërkuara të tilla si, duke mos u kufizuar vetëm në to, informacionin aeronautik, informacion e Zyrës së Shërbimit të Raportimit të Trafikut Ajror (ZRA), informacion meteorologjik dhe informacion të menaxhimit të fluksit;

b) mbështet modernizimin dhe harmonizimin e ofrimit të informacionit aeronautik në kuptimin e tij më të gjerë, në bashkëpunim të ngushtë me Eurokontrollin dhe ICAO.”

3.4 Neni 4 ndryshohet si me poshtë:

“Neni 4

### Rregullat e ajrit dhe klasifikimit të hapësirës ajrore

AAC-ja merr masa për projektimin e rregullave të zbatimit në përputhje me legjislacionin evropian, në mënyrë që:

a) të miratohen dispozita të përshtatshme për rregullat për ajrin bazuar në standardet e ICAO dhe praktikatat e rekomanduara;

b) të harmonizohet zbatimi i klasifikimit të hapësirës ajrore të ICAO, me përshtatjen e duhur, në mënyrë që të sigurohet ofrimin e duhur të sigurt dhe efikas të shërbimeve të trafikut ajror brenda qiellit të vetëm evropian.”

3.5 Neni 5 shfuqizohet.

3.6 Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

### Menaxhimi dhe projektimi i rrjetit

1. Funkcionet e Rrjetit të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA) lejojnë përdorimin optimal të hapësirës ajrore dhe sigurojnë që përdoruesit e hapësirës ajrore të mund të operojnë në trajektorët e preferuara, duke lejuar ndërkohë një akses maksimal në hapësirën ajrore dhe në shërbimet e lundrimit ajror. Këto funksione të rrjetit synojë të mbështesin iniciativat në nivel kombëtar dhe në nivelin e blloqeve funksionale të hapësirës ajrore dhe zbatohen në një mënyrë që respekton ndarjen e detyrave rregullatore dhe operationale.

2. Për të arritur objektivat e përmendura në pikën 1 dhe pa cenuar përgjegjësitë shtetërore në lidhje me rrugët dhe strukturat e hapësirës ajrore kombëtare, Komisioni siguron që funksionet e mëposhtme janë realizuar:

a) projektimi i rrjetit evropian të rrugëve;

b) koordinimi i burimeve të pakta brenda bandave të frekuencave të aviacionit të përdorura nga trafiku ajror i përgjithshëm, në veçanti frekuencave e radios, si dhe koordinimin e kodeve të lëshuesve të sinjalit të radarëve.

3. Aspektet e projektimit të hapësirës ajrore, përveç atyre të përmendura në pikën 2 duhet të trajtohen në nivel kombëtar ose në nivel të blloqeve funksionale të hapësirës ajrore. Ky proces i projektimit merr në konsideratë nevojat dhe kompleksitetin e trafikut, planet e performancës kombëtare apo të bllokut funksional të hapësirës



ajrore dhe përfshin konsultimin e plotë të përdoruesve të hapësirës ajrore ose grupet përkatëse që përfaqësojnë përdoruesit e hapësirës ajrore dhe autoriteteve ushtarake sipas rastit.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil, në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar, i beson Eurokontrollit ose një organi tjetër të paanshëm dhe kompetent realizimin e menaxhimit të fluksit të trafikut ajror, bazuar në rregullat përkatëse për mbikëqyrjen.

5. AAC merr masa për projektimin e rregullave zbatuese për menaxhimin e fluksit të trafikut ajror, përfshirë rregullat e nevojshme të mbikëqyrjes, në përputhje me rregullat zbatuese të nxjerra nga Komisioni, me synimin për të optimizuar kapacitetin e disponueshëm në përdorimin e hapësirës ajrore dhe përmirësimin e procesit të menaxhimit të fluksit të trafikut ajror.

Këto rregulla bazohen më transparencë dhe efikasitet, duke siguruar që kapaciteti të sigurohet në mënyrë fleksibël në kohë, në përputhje me rekomandimet e Planit Rajonal të Navigacionit Ajror, ICAO, Rajoni Evropian.

6. Rregullat zbatuese për menaxhimin e fluksit të trafikut ajror mbështesin vendimet operationale nga ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror, operatorët e aeroportit dhe përdoruesit e hapësirës ajrore dhe mbulojnë fushat e mëposhtme:

a) planifikimin e fluturimit;

b) përdorimin e kapacitetit të disponueshëm të hapësirës ajrore gjatë të gjithë fazat jashtë fluturimit, përfshirë caktimin e vendeve të parkimit; dhe

c) përdorimin e përcaktimit të kalimeve në rrjet (*rountig-ut*) nga trafiku ajror i përgjithshëm:

- krijimin i një publikimi të vetëm për orientimin e rrugëve dhe të trafikut,

- opsione për devijim të trafikut ajror të përgjithshëm nga zonat e mbingarkuara, dhe

- rregulla mbi prioritetin lidhur me aksesin në hapësirën ajrore për trafikun ajror të përgjithshëm, veçanërisht gjatë periudhave të mbingarkesës dhe krizës.

7. Gjatë zhvillimit dhe miratimit të rregullave zbatuese, sipas nevojës dhe pa cenuar sigurinë, merret në konsideratë pajtueshmëria ndërmjet planeve të fluturimit dhe vendeve të parkimit të aeroportit dhe bashkërendimin e nevojshëm me rajonet fqinje.”

3. 7. Neni 9 shfuqizohet.

4. Në udhëzimin e ministrit nr. 8 datë 3.6.2010 “Për ndërveprimin në Rrjetin Evropian të menaxhimit të trafikut ajror”, bëhen këto ndryshime:

4.1 Pas nenit 6, shtohet neni i 6a, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 6a

#### **Verifikim alternativ i përputhshmërisë**

Një certifikatë e lëshuar në përputhje me këtë udhëzim, ku kjo zbatohet për njësitë ose sistemet, merret në konsideratë, për efekt të neneve 5 dhe 6 të këtij udhëzimi, si një deklaratë konformitetit e AAC apo përshtatshmërie për përdorim, ose si një deklaratë verifikimi, e AAC, nëse ajo përfshin demonstrim të pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të këtij udhëzimi dhe rregullat përkatëse zbatuese për ndërveprimin.”

4.2 Neni 9 shfuqizohet.

4.3 Në nenin 10, pas pikës 2, shtohet pika 2a si më poshtë:

“2.a Për qëllimet e paragrafit 2 të këtij neni, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të deklarojë sistemet dhe përbërësit e ATMN si në përputhje me kërkesat thelbësore dhe të bëjë përfundim nga parashikimet e neneve 5 dhe 6.”

4.4. Në aneksin II bëhen ndryshimet si më poshtë:

4.4.1 Në pjesën A, paragrafi i parë i pikës 2, ndryshohet si më poshtë:

“EATMN, sistemet e tij dhe përbërësit e tij mbështesin, mbi një bazë të koordinuar, koncepte të reja të rena dakord apo të vleftësuar të operimit që përmirësojnë cilësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e shërbimeve të lundrimit ajror, në veçanti në aspektin e sigurisë dhe kapacitetit.”

4.4.2 Në pjesën B bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë i pikës 3.1.2, ndryshohet si më poshtë:

“Sistemi i përpunimit të të dhënave të fluturimit akomodon zbatimin progresiv të koncepteve të avancuara, të pranuar dhe të vleftësuar të operimit për të gjitha fazat jashtë fluturimit, në veçanti siç parashihet në Master Planin e MTA.”

b) Pika 3.2.2 ndryshohet si më poshtë:

“3.2.2 Mbështetje për koncepte të reja të operimit

Sistemet e procesimit të të dhënave të mbikëqyrjes mbështesin disponueshmërinë progresive të burimeve të reja të mbikëqyrjes së



informacionit në mënyrë që të zhvillojnë cilësinë e përgjithshme të shërbimit, në veçanti të theksuar në Master Planin e MTA.”.

c) Pika 4.2 ndryshohet si më poshtë:

“4.2 Mbështetje për koncepte të reja të operimit  
Sistemet e komunikimit mbështesin zbatimin e koncepteve të avancuara, të pranuar dhe të vlefshme të operacionit për të gjithë fazat jashtë fluturimit, në veçanti siç parashihet në Master Planin e MTA.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
**Edmond Haxhinasto**

### URDHËR

Nr. 124, datë 28.9.2015

#### **PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KËRKESAT E PËRBASHKËTA TË PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE DHE PROCEDURAVE TË OPERIMIT PËR SHMANGIEN E PËRPLASJEVE AJRORE<sup>2</sup>**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, shkronja “ç”, të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”,

### URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
**Edmond Haxhinasto**

### RREGULLORE

#### **PËR KËRKESAT E PËRBASHKËTA TË PËRDORIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE DHE PROCEDURAVE TË OPERIMIT PËR SHMANGIEN E PËRPLASJEVE AJRORE**

Neni 1

#### **Përmbajtja e lëndës dhe fushëveprimi**

Kjo rregullore përcakton kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat e operimit për shmangien e përplasjeve ajrore për t'u përmbushur nga:

a) operatorët e avionit referuar në nenin 4 (1), (b) dhe (c) të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar me udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 13.3.2015, për fluturimet e ndërmarra në brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë; dhe

b) operatorët e avionit referuar në nenin 4 (1) (b) të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar me udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 13.3.2015, për fluturimet e ndërmarra në hapësirën ajrore mbi territorin e të cilit zbatohet Marrëveshja Shumëpalëshe, ratifikuar në vendin tonë me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”.

Neni 2

#### **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

<sup>2</sup> Ky urdhër përafuron rregulloren nr. 1332/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 16 dhjetor 2011 “Për kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore”.



1. “Sistemi për shmangien e përplasjeve ajrore (ACAS)” do të thotë një sistem avioni i bazuar në mbikëqyrjen e radarit sekondar (RSS) me sinjale transponderi e cila operon në mënyrë të pavarur nga pajisjet bazë të tokës, që i jep këshilla pilotit mbi konflikte potenciale me avionë, të cilët janë të pajisur me transpondera RSS;

2. “Sistemi për shmangien e përplasjeve ajrore II (ACAS II)” nënkupton një sistem për shmangien e përplasjeve ajrore, i cili siguron këshillat për zgjidhjet vertikale përveç këshillave të trafikut;

3. “Treguesi i rekomanduar i zgjidhjes (RA)” nënkupton një tregues të caktuar për të rekomanduar ekuipazhin e fluturimit në një manovër me qëllim që të sigurojë ndarjen nga të gjitha kërcënimet ose një kufizim manovrues që synon të ruajë ndarjen ekzistuese;

4. “Tregues i rekomanduar (TA) i trafikut” nënkupton një tregues i caktuar për ekuipazhin e fluturimit se afërsia e një tjetër avioni është një kërcënim potencial.

Neni 3

#### **Sistemi për shmangien e përplasjeve ajrore (ACAS)**

1. Aeroplanët e përmendura në seksionin I të aneksit të kësaj rregulloreje do të jenë të pajisur dhe operojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat siç specifikohen në aneks.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa që të sigurojë operimin e avionëve referuar në nenin 1(2)(a) të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar me udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 13.3.2015, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në aneks, në përputhje me kushtet e përcaktuara në atë nen.

Neni 4

#### **Dispozitat e veçanta të aplikimit të operatorëve që i nënshtrohen urdhrimit të ministrit nr. 92, datë 28.9.2011, që miraton rregulloren “Për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në aviacionin civil”**

1. Duke u shmangur nga dispozitat e OPS 1.668 dhe OPS 1.398 të aneksit III, të urdhrimit të ministrit nr. 92, datë 28.9.2011, që miraton rregulloren “Për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në aviacionin civil”, neni 3 dhe aneksi i kësaj rregulloreje do të zbatohen për operatorët e avionëve të referuara në nenin 1 (a).

2. Çdo detyrim tjetër për operatorët ajrorë, i përcaktuar nga urdhri i ministrit nr. 92, datë 28.9.2011, që miraton rregulloren “Për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në aviacionin civil”, përsa i përket miratimit, instalimit apo funksionimit të pajisjeve, do të vazhdojë të zbatohet për ACAS II.

Neni 5

#### **Zbatimi**

Në rastin e një avioni me një certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar para datës 1 mars 2012, dispozitat e neneve 3 dhe 4 do të zbatohen duke filluar nga data 1 dhjetor 2015.

ANEKS

#### **SISTEMI PËR SHMANGIEN E PËRPLASJEVE AJRORE (ACAS) II (Part-ACAS)**

Seksioni I - ACAS II Pajisjet

AUR.ACAS.1005 Kërkesa e performancës

1) Avionët e mëposhtëm me turbinë do të jenë të pajisur me version logjik 7.1, të ACAS II për shmangien e përplasjes:

- avionët me një masë maksimale të certifikuar të ngritjes (*take-off*) më të madhe se 5 700 kg; ose
- avionët e autorizuar për të transportuar më shumë se 19 pasagjerë.

2) Avionët që nuk janë përmendur në pikën (1), por të cilët do të jenë të pajisur mbi një bazë vullnetare me ACAS II, do të kenë version logjik 7.1 të shmangies së përplasjes.

3) Pika (1) nuk aplikohet tek sistemet e avionëve pa pilot.

Seksioni II - Operimet

AUR.ACAS.2005 Përdorimi i ACAS II

1) ACAS II do të përdoren gjatë fluturimit, përveç rasteve kur parashikohet në listën e pajisjeve minimale, siç specifikohet në aneksin III të urdhrimit të ministrit nr. 92, datë 28.9.2011, që miraton rregulloren “Për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në aviacionin civil”, në një mënyrë që u mundëson shenjat (indikimet) RA, të prodhuara për ekuipazhin fluturues kur është zbuluar një afërsi e panevojshme me një tjetër avion, pa frenimin e indikatorit RA (duke përdorur vetëm treguesin TA ose ekuivalentin), e kërkuar nga një procedurë jo normale ose e lidhur me një performacë të kufizuar nga kushtet.



2) Kur një shenjë RA është prodhuar nga ACAS II:

a) piloti fluturues, menjëherë, do të konfirmojë indikacionet e treguesit RA, edhe nëse kjo bie në kundërshtim me një udhëzim të kontrollit të trafikut ajror (ATC), pa rrezikuar sigurinë ajrore të avionit.

b) ekuipazhi i fluturimit, sa më shpejt që lejohet nga ngarkesa e punës, do të njoftojë njësinë e duhur ATC të çdo RA-je e cila kërkon një devijim nga udhëzimi aktual i ATC-së ose leje fluturimi;

c) kur konflikti është zgjidhur, avioni:

i) do të kthehet me përpikëri tek kushtet e pranuar të instruksionit ATC ose të lejuara dhe ATC do të regjistrojë manovrimet; ose

ii) në përputhje me ndonjë ndryshim të lejes së ATC apo instruksionit të nxjerrë.

AUR.ACAS.2010 Trajnimi i ACAS II

Operatorët do të krijojnë procedurat operative të ACAS II dhe programet e trajnimit në mënyrë që ekuipazhi i fluturimit është i trajnuar siç duhet në shmangien e përplasjeve dhe kompetente në përdorimin e pajisjeve ACAS II.

Shkurtimet dhe emërtimet e përdorura sipas Rregullores Europiane (EU) Nr. 1332/2011 :

(ACAS)“*Airborne Collision Avoidance System*”

(ACAS II)“*Airborne Collision Avoidance System IP*”

(RA)“*Resolution Advisory*”

(TA)“*Traffic Advisory*”



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës”Shqipëria Sot”,  
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 539 lekë